



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

*Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit*

---

Nr. 813/9 Prot.

Tiranë, më 24/12/2016

### V E N D I M

**Nr.158, Datë 24/ 12/2016**

#### PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË AGJENCINË E TRAJTIMIT TË PRONAVE TIRANË “PËR LIGJSHMËRINË RREGULLSHMËRINË E AKTIVITETIT TË INSTITUCIONIT, MBI PROCEDURËN E KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE DHE VEPRIMTARINË EKONIMIKO FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, mendimin e Drejtorit Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

#### V E N D O S A:

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Auditim tematik dhe vlerësues për ligjshmërinë rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit, mbi procedurën e kthimit dhe kompensimit të pronave dhe veprimtarinë ekonomiko financiare*”, ushtruar në Agjencinë e Trajtimit të Pronave Tiranë”, për periudhën 01.01.2014 deri më 30.06.2016.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**Gjetje 1: ATP Tiranë** si në periudhën para v. 2013 ashtu dhe për çdo vit të periudhës 2014-30.6.2016 nuk hartuar dokumentet e strategjisë, planveprimit ku të përfshinte 4 objektivat e Programit të Qeverisë si një nga 6 prioritetet, në fushën e trajtimit të së drejtës së pronës dhe objektivat përcaktuar në VKM 236, datë 23.4.2014“Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Vendimit Pilot të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “M P dhe të tjerë kundër

Shqipërisë”; si dhe nuk ka paraqitur dokumente raporte vjetore për kryerjen e monitorimit dhe raportimin e realizimit të **objektivave të Programit të Qeverisë dhe matricës së treguesve të planveprimeve përkatës**; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, me ligjin nr. 133, datë 05.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” dhe me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore përkatëse; konkretisht lidhur me:

**1.a.** ATP Tiranë ka afishuar në webside Programin e prezantuar të Qeverisë, si një nga 6 prioritetet, në fushën e trajtimit të së drejtës së pronës, përbërë nga 4 objektiva cituar:

1. Në **3 vjet** do të mbyllet procesi 25 vjeçar i njohjes së pronësisë dhe do të përfundojë vlerësimi ekonomik i **26 mijë** vendimeve për kompensim,

2. Është krijuar **fondi i qëndrueshëm dhe i paprekshëm për kompensimin**,

3. **Kompensimi fizik do të ketë përparësi** kundrejt çdo forme kompensimi tjetër.

4. Pavarësisht kësaj, qeveria ka planifikuar me ligj një fond prej **50 miliard lekësh** në dispozicion të fondit të kompensimit financiar të pronave i cili është planifikuar të shpërndahet në 10 vjet proces,

**1.b. Në ligjin nr. 133/2015, miratuar në datën 5.12.2015 Shtojca 2** përcaktohen:

*Në miliard lekë*

Vitet	viti 1	viti 2	viti 3	viti 4	Viti 5	viti 6	Viti 7	Viti 8	viti 9	viti 10	Totali
Miliard lekë	3,00	3,33	3,69	4,10	4,54	5,04	5,59	6,20	6,88	7,63	50
vitet	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026

**Në nenin 37 përcaktohet:** ”Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij. Deri në nxjerrjen e këtyre akteve, aktet nënligjore ekzistuese vazhdojnë të mbeten në fuqi, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.”

**1.c. Baza nënligjore e nxjerrë para dhe gjatë periudhës 2014-2016**

VKM nr. 1077, datë 18.06.2008 “Për krijimin e fondit të Kompensimit Fizik nga **fondi pyjor dhe kullor**” prej **50,989,76 ha (vlerësuar 60 miliard lekë)**,

VKM nr. 236, datë 23.04.2014 “Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Vendimit Pilot të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”.

VKM nr. 770, datë 12.11.2014 “Për kalimin në fondin e kompensimit fizik në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të sipërfaqes së **tokës bujqësore 23,368,8 ha** në pronësi shtetërore dhënë në përdorim të njësive të qeverisjes vendore” (vlerësuar **37 miliard lekë** sipas VKM nr 89, datë 3.2.2016)

VKM, nr. 889, datë 17.12.2014 ‘Për përcaktimin e rregullave dhe të kriterëve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve në të holla për v. 2014”,

VKM nr. 929, datë 29.12.2014 ‘Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes “

VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin e Shlyerjeve të Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”

VKM, nr.134, datë 12.2.2015 ‘Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale”

VKM, nr.258, datë 25.3.2015 ‘Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale”

VKM nr 89,datë 3.2.2016”Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”

VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të ATP”,  
VKM nr. 222, datë 23.3.2016 “Për Trajtimin e Kërkesave për Njohje të Pronës e të kompensimit të saj”

VKM nr. 223, datë 23.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (*Trajtuar në faqet 5-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 1:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa ndjekë procedurat përkatëse të hartojë e miratojë dokumentin e strategjisë përcaktuar me afate, planveprimet afat mesëm e vjetore, matricat e treguesve, ku të përfshihen 4 objektivat e Programit të Qeverisë si një nga 6 prioritetet, në fushën e trajtimit të së drejtës së pronës dhe objektivat përcaktuar në VKM 236, datë 23.4.2014“Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Vendimit Pilot të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”; si dhe të paraqiten dokumente raporte vjetore të monitorimit dhe raportimin e realizimit **të objektivave të Programit të Qeverisë dhe matricës së treguesve të planveprimeve përkatës, dokumente këto të munguara, mbështetur në:**

**1.a.** Afishimin e prezantuar në webside të Programit të Qeverisë, si një nga 6 prioritetet, në fushën e trajtimit të së drejtës së pronës, përbërë nga 4 objektiva cituar:

1. Në **3 vjet** do të mbyllet procesi 25 vjeçar i njohjes së pronësisë dhe do të përfundojë vlerësimi ekonomik i **26 mijë** vendimeve për kompensim,

2. Është krijuar **fondi i qëndrueshëm dhe i paprekshëm për kompensimin**

3. **Kompensimi fizik do të ketë përparësi** kundrejt çdo forme kompensimi tjetër.

4. Pavarësisht kësaj, qeveria ka planifikuar me ligj një fond prej **50 miliard lekësh** në dispozicion të fondit të kompensimit financiar të pronave i cili është planifikuar të shpërndahet në 10 vjet proces,

**1.b.** Në ligjin nr. 133/2015, miratuar në datën 5.12.2015 **Shtojca 2** përcaktohen:

#### *Në miliard lekë*

Vitet	viti 1	viti 2	viti 3	viti 4	Viti 5	viti 6	Viti 7	Viti 8	viti 9	viti 10	Totali
Miliard lekë	3,00	3,33	3,69	4,10	4,54	5,04	5,59	6,20	6,88	7,63	50
vitet	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026

**Në nenin 37përcaktohet:** ”Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave nxjerr aktet e nevojshme nënligjore në bazë dhe për zbatim të tij. Deri në nxjerrjen e këtyre akteve, aktet nënligjore ekzistuese vazhdojnë të mbeten në fuqi, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me këtë ligj.”

**1.c.** Dhe mbështetur në Bazën nënligjore në fuqi të nxjerrë para dhe gjatë periudhës 2014-2016 cituar më sipër.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 2.** ATP Tiranë për periudhën 2014-30.6.2016 nuk ka ndjekur hapat e duhur ligjor për instalimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit pra dhe nuk ka hartuar e zbatuar dokumentet lidhur me:

**I.** Organizimi i procesit. Hartimi i deklaratës së qëllimit, misionit, vizionit dhe objektivave themelore të aktivitetit. Plani strategjik, miratimi dhe monitorimi i tij.

Nga auditimi nuk u paraqit dokumenti “**Deklarata e Misionit, vizionit, qëllimit dhe objektivave Themelore të aktivitetit**”, i cili do të përfshinte së paku 4 objektiva strategjik që burojnë nga programi i qeverisë, ligji funksional, objektiva të cilat do të pasqyrojnë në mënyrë të qartë, konkrete e koncize Misionin, Vizionin dhe objektivat e ATP në mënyrë të matshme të krahasueshme për treguesit kryesor të synuar për tu arritur dhe të arritur për **objektivat themelor të aktivitetit** të ATP-

së për vitet 2014, 2015 dhe 2016, *mungesa e të cilëve sjell pamundësinë e monitorimit dhe vlerësimit.*

*Gjithashtu, nuk ka ose nuk u paraqit ndonjë dokument për analizën dhe raportimin e treguesve të parashikuar dhe të monitoruar për realizimin e objektivave themelor të aktivitetit për ATP në secilin prej viteve 2014 dhe 2015; ekzistenca e të cilit do të krijonte mundësinë, për audituesin por edhe për publikun, të dhënies së një opinioni vlerësues lidhur me arritjen e objektivave për secilin prej viteve 2014 dhe 2015 (Trajtuar në faqet 5-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim 2:** ATP Tiranë Drejtori i Përgjithshëm të marrë masat të ndjekë procedurat dhe hapat e duhur ligjor për instalimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit pra të hartojë e të zbatojë dokumentet përkatës si:

*Deklarata e Misionit, vizionit, qëllimit dhe objektivave Themelorë të aktivitetit*”, i cili të përfshijë 4 objektiva strategjik që burojnë nga programi i qeverisë, ligji funksional, objektiva të cilat të pasqyrojnë në mënyrë të qartë, konkrete e koncize Misionin, Vizionin dhe objektivat e ATP matricën përkatëse, në mënyrë të matshme të krahasueshme të treguesve kryesor të synuar për tu arritur dhe të arritur për *objektivat themelor të aktivitetit* të ATP-së për periudhat përkatëse.

**Menjëherë**

**Gjetje 3:** ATP Tiranë nuk ka hartuar e miratuar dokumentin e Strategjisë dhe plan-veprimet përkatëse lidhur me parashikimin, zbërthimin, programimin, monitorimin e raportimin e treguesve të matshëm e të pamatshëm që i përkasin 4 objektivave kryesore të Programit të Qeverisë, e konkretisht;

**Për objektivin përshkruar:** *”Në 3 vjet do të mbyllet procesi 25 vjeçar i njohjes së pronësisë dhe do të përfundojë vlerësimi ekonomik i 26 mijë vendimeve për kompensim”*, nuk është bërë ndarja në tre vite 2014-2017 dhe nuk është raportuar monitorimi për periudhën 2014,2015 dhe 6 mujorin I-rë 2016, ndërsa nuk është shprehur e raportuar niveli i këtij treguesi të parashikuar dhe të realizuar,

**Për objektivin përshkruar:** *”Është krijuar fondi i qëndrueshëm dhe i paprekshëm për kompensimin”,* qe lidhet me kompensimin financiar; nuk është bërë ndarja e fondit për secilin prej 3 vitesh 2014, 2015 dhe 2016 që sipas shtojcës 2 të ligjit përcaktohen *3 miliard, 3,33 miliard dhe 3,69 miliard lekë*, ndërsa nuk është shprehur e raportuar niveli i këtij treguesi të parashikuar dhe të realizuar,

**Për objektivin përshkruar:** *“Kompensimi fizik do të ketë përparësi kundrejt çdo forme kompensimi tjetër”,* qe lidhet me kompensimin fizik për të cilin nuk parashikuar e përfshirë në dokumentin e strategjisë treguesit e shpërndarjes si fond kompensimi fizik të tokës bujqësore prej *23,368,8 ha* vlerësuar me vlerësuar *37 miliard lekë* dhe të fondi pyjor dhe kulloror” prej *50,989,76 ha, vlerësuar 60 miliard lekë* si dhe *të 150 objekteve*, vlerësuar në vlerën *2,1 miliard lekë*; ndërsa nuk është shprehur e raportuar niveli i këtyre 3 treguesve të parashikuar dhe të realizuar,

Nuk ka përditësuar e përfshirë në planveprim objektivat përcaktuar në VKM nr. 236, datë 23.04.2014 *“Për Miratimin e Planit të Veprimet për Zbatimin e Vendimit Pilot të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”*, ndërsa nuk është shprehur e raportuar niveli i këtyre treguesve të parashikuar dhe të realizuar,

Gjithashtu nuk ka përcaktuar *objektivat dhe treguesit në shtrirje kohore dhe si numër që lidhen me ndryshimin e akteve nën ligjore* të nevojshme për zbatimin e *4 objektivave themelore* të Programit të Qeverisë; si dhe nuk është shprehur e raportuar niveli i këtyre treguesve të parashikuar dhe të realizuar; gjendje kjo në kundërshtim me nenin 9, pika 4, germa “b” neni 8 germa “b” dhe me nenin 27 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (Trajtuar në faqet 5-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim 3:** ATP Tiranë në hartimin e miratimin e dokumentit të Strategjisë dhe plan-veprimet përkatëse të përfshijë objektivat lidhur me parashikimin, zbërthimin, programimin, monitorimin e

raportimin e treguesve të matshëm e të pamatshëm që i përkasin 4 objektivave kryesore të Programit të Qeverisë, dhe konkretisht;

**Për objektivin përshkruar:** *”Në 3 vjet do të mbyllet procesi 25 vjeçar i njohjes së pronësisë dhe do të përfundojë vlerësimi ekonomik i 26 mijë vendimeve për kompensim”*, nuk është bërë ndarja në tre vite 2014-2017 dhe të raportojë e marrë në konsideratë monitorimin e këtij treguesi për periudhën 2014,2015 dhe 6 mujorin I-rë 2016 në korrektim planveprimit që do hartohet .

**Për objektivin përshkruar:** *”Është krijuar fondi i qëndrueshëm dhe i paprekshëm për kompensimin”,* që lidhet me kompensimin financiar; të bëhet ndarja e fondit për secilin prej 3 vitesh 2014,2015 dhe 2016 që sipas shtojcës 2 të ligjit ku përcaktohen **3 miliard, 3,33 miliard dhe 3,69 miliard lekë** dhe të shprehet e merret në konsideratë niveli i parashikuar dhe realizuar, i këtij treguesi, në korrektim planveprimit që do hartohet.

**Për objektivin përshkruar:** *“Kompensimi fizik do të ketë përparësi kundrejt çdo forme kompensimi tjetër”,* që lidhet me kompensimin fizik për të cilin nuk parashikuar e përfshirë në dokumentin e strategjisë treguesit e shpërndarjes si fond kompensimi fizik të tokës bujqësore prej **23,368,8 ha** vlerësuar me **37 miliard lekë** dhe të fondi pyjor dhe kullosor” prej **50,989,76 ha, vlerësuar 60 miliard lekë** si dhe **të 150 objekteve**, vlerësuar në vlerën **2,1 miliard lekë**; tregues të cilët të përfshihen si nivel parashikimi e realizimi në strategjinë, matricën e treguesve të planveprimit që do të hartohet e monitorohet,

Të përfshihet një **objektiv me përshkrimin:** Përditësimi e përfshirja në planveprim e objektivave përcaktuar në VKM nr. 236, datë 23.04.2014 *“Për Miratimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Vendimit Pilot të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”,* si dhe të përcaktohen treguesit përkatës si nivel parashikimi dhe nivel realizimi

Të përfshihet një **objektiv me përshkrimin:** Përcaktimi dhe përfshirja e *objektivit që lidhet hartimin e akteve të reja dhe ndryshimin e akteve ekzistuese nën ligjore, treguesit si numër dhe shtrirje kohore* të nevojshme për zbatimin e **4 objektivave themelore** të Programit të Qeverisë, si dhe të përcaktohen treguesit përkatës si nivel parashikimi dhe nivel realizimi.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 4:** Në ATP Tiranë, mungonin fizikisht dhe nuk janë hartuar, përcaktuar e monitoruar dokumentet *“Regjistri i Riskut” dhe “Strategjia afatmesme e menaxhimit të risqeve”* parësore që pengojnë realizimin e objektivave kryesore strategjik dhe njëkohësisht objektivat lidhur me hartimin, zbatimin e PB dhe PBA, dokumente të cilat përcaktojnë bazat për menaxhimin e riskut, gjendje në mos përmbushje të nenit, 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

2. Megjithëse është ngritur GSM por nuk është miratuar nga GSM Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit, çka është në mos përmbushje të Kreut të III, nenet 19-22 të nr. 10296, datë 8.7.2010.

3. Mungojnë e nuk janë caktuar nga Titullari, procedurat e brendshme të anti-korrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive, që është në mos përmbushje të nenit 8, pika 8 (e) dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

4. Mungon përshkrimi i proceseve dhe veprimeve, miratimi i tyre lidhur me qarkullimin e dokumentacionit shkresor dhe përfshirja e tyre e normuar me rregulloren përkatëse në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe të UMF nr 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”* dhe dokumentacioni i AQT.

#### *5-Mbikëqyrja e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve.*

Nëpunësi autorizues nuk ka bërë ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit. Mungojnë përcaktimi i Procedurave të brendshme që garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në mënyrën e duhur në kryerjen e detyrave të tyre.

6-Gjurmët e auditimit. (Ecuria e proceseve,objektivat strukturat brenda dhe jashtë njësisë, sistemet mbështetëse të IT, afatet,burimet e tjerë). Dokumentet ligjore, financiare, ose të një natyre tjetër, që rregullojnë dhe mbështetin aktivitetet që janë pjesë e këtyre proceseve.

Në ATP Tiranë, nuk është miratuar dokumenti i gjurmës së auditimit dhe nuk ndodhej i arkivuar gjurma e auditimit, në kundërshtim me nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, UMF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe UMF nr. 29, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

7 -Mungon e nuk janë plotësuar **tre dokumentet përkatësisht**; Deklarata e SKB, Raporti për funksionimin e SKB (me 5 komponentët përkatës) dhe mungon dokumenti i plotësuar “Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK për vitin 2014 dhe 2015”, gjendje në kundërshtim me nenin 6, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor Për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike” formati sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, si dhe në mos përmbushje të neneve 17 dhe 29 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 18 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” (Trajtuar në faqet 5-14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 4:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa të hartojë miratojë monitorojë dhe të raportojë dokumentet e munguara si:

1. Dokumentin “**Regjistri i Riskut**” dhe “**Strategjia afatmesme e menaxhimit të risqeve**” që pengojnë realizimin e objektivave kryesore dhe objektivave lidhur me hartimin,zbatimin monitorimin e PB dhe PBA,

2. Të ngrejë strukturat përkatëse, GSM dhe të kërkojë hartimin, miratimin, zbatimin e monitorimin nga GSM të dokumenteve Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit,

3. Të hartohen,caktohen e monitorohen nga Titullari, dokumenti lidhur me procedurat e brendshme të anti-korrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive,

4. Të hartohen, caktohen e monitorohen nga Titullari, dokumenti lidhur me përshkrimi i proceseve dhe veprimeve, miratimi i tyre lidhur ne qarkullimin e dokumentacionit shkresor dhe përfshirja e tyre e normuar me rregulloren përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe të UMF nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe dokumentacioni i AQT.

5- Lidhur me *Mbikëqyrjen e vendimeve dhe veprimeve të menaxherëve, Titullari, Nëpunësi autorizues të bëjë ndarjen e përgjegjësive që lidhen me vendimmarrjen, kontrollin, zbatimin dhe vendosjen e linjave të raportimit. Të përcaktojë Procedurat e brendshme që garantojnë se, punonjësit mbikëqyren në mënyrën e duhur në kryerjen e detyrave të tyre.*

6- *Lidhur me Gjurmët e auditimit. (Ecuria e proceseve,objektivat strukturat brenda dhe jashtë njësisë, sistemet mbështetëse të IT, afatet,burimet e tjerë). Dokumentet ligjore, financiare, ose të një natyre tjetër, që rregullojnë dhe mbështetin aktivitetet që janë pjesë e këtyre proceseve.*

ATP Tiranë, Titullari të miratojë njohë punëmarrësit dhe ta arkivojë dokumentin e gjurmës së auditimit, sipas kërkesave të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, UMF nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe UMF nr. 29, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

7. Drejtori i Përgjithshëm, të marrë masa hartojë, plotësojë, miratojë monitorojë dhe raportoje **tre dokumentet e munguara përkatësisht**; Deklarata e SKB, Raporti për funksionimin e SKB (me 5 komponentët përkatës) dhe plotësojë e dërgojë dokumentin “Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK të munguara për vitin 2014 dhe 2015”, sipas nenit 6, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi Paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor Për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike” formati sipas Shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, si dhe në përmbushje të neneve 17 dhe 29 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin

e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 18 të ligjit 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 5:** ATP Tiranë ka përgatitur, hartuar buxhete PB dhe PBA për vitet 2015, 2016 dhe 2017, të pa mbështetur në dokumentet themelor si Objektivat, Strategjia dhe plan-veprimet përkatëse (të cilat mungojnë nuk janë hartuar) dokumente këto që orientojnë e argumentojnë kërkesat buxhetore. Buxhetet e hartuara kanë mangësi në drejtim të *paqëndrueshmërisë të emërtimit të produkteve dhe nënprodukteve, me moszbatim të kriterit të rritjes 10%, pra buxhete të paargumentuara me rezerva e jo funksional dhe që kanë sjellë pasojë mosrealizime me ndikim në mos përmbushje të misionit qëllimit dhe objektivave të ATP-së*, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse (*Trajtuar në faqet 14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 5:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe strukturat përkatëse, të përgatisë e hartojë buxhete PB dhe PBA për vitet në vazhdim, të mbështetur në dokumentet themelor si Objektivat, Strategjia dhe plan-veprimet përkatëse (të cilat të jenë hartuar miratuar më parë) që shërbejnë si bazë orientuese, argumentuese dhe të fiksojë dhe standardizojë listën *e emërtimit të produkteve dhe nënprodukteve ekzistuese duke bërë kujdes për emërtimin dhe matshmërinë e produkteve të reja mbështetur në ligjin organik të trajtimit të pronave si dhe të zbatojë kriteret të rritjes 10% me synim hartimin e buxhete të argumentuara, të realizueshëm e në funksion të përmbushjes së misionit, vizionit, qëllimit objektivave dhe planveprimeve të ATP-së*, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjit nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe të udhëzimeve përkatëse.

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 6:** ATP Tiranë ka pamjaftueshmëri të menaxhimit dhe zbatimit të PB dhe PBA për periudhat vjetore 2014, 2015 dhe 6 mujorin e I-rë 2016, që rrjedh nga pamjaftueshmëria e monitorimit dhe raportimet e parregullta nga njësitë vartëse të treguesve të raportuara vetëm në nivelin faktik, të pa tabeluar dhe të pa krahasuar me nivelet e parashikuar, në kundërshtim me normat e programimi; që kanë sjellë mosrealizime vjetore të treguesve të nivelit të shpenzimeve i cili luhetet në diapazonin 81,3 %- 89 %, sipas Formatit nr. 6 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve”, mosrealizim të nivelit të raporteve të shpenzimeve të programeve, i cili luhetet në diapazonin në zbrisje 94 %; 80,7 %; 88,3 %, sipas Formatit nr. 7 “Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve” si dhe mosrealizime të treguesit të produkteve që sipas Formatit nr. 8 “Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programeve”, të cilat për gjithë periudhën nga 11 produkte, 4 nuk janë realizuar aspak, 9 produkte janë realizuar në nivelet: 4 plotësisht, 7 pjesërisht; gjendje kjo me pasojë mos *përmbushje të misionit, vizionit, qëllimit, objektivave, strategjik dhe planveprimeve të ATP-së*, në kundërshtim me ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, dhe udhëzimet përkatëse, në kundërshtim me ligjin nr. 185/2013, datë 2.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014”, ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e Vitit 2015”, ligjit nr. 147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, dhe me Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” (*Trajtuar në faqet 14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 6:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të marrin masat për menaxhimin, monitorimin, raportimet nga njësitë vartëse të treguesve në nivelin faktik e krahasuar dhe të tabeluar me nivelet e parashikuar në përputhje me normat e programimi; me synim sigurimin e zbatimit e PB dhe PBA dhe të treguesve përkatës si; niveli i shpenzimeve sipas Formatit nr. 6 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve”, treguesit niveli i raporteve të

shpenzimeve të programeve, sipas Formatit nr. 7 “Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve” dhe treguesit sipas Formatit nr. 8 “Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programeve”, në çdo periudhë dhe secilin produkt me synim përmbushjen e *misionit, vizionit, qëllimit, objektivave strategjik dhe planveprimeve të ATP-së*,

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 7:** Në ATP Tirane, Sektori Financës nga auditimi i gjendjes financiare përmes librave të kontabilitetit sintetizuar në Pasqyrat financiare dhe anekset përkatëse të bilanceve në secilën prej periudhave ushtrimore 2014, 2015 dhe 2016 rezultojnë se:

Evidenca kontabël analitike e detyrimeve mbajtur në llogaritë 6027 “Shpenzime për detyrime për Kompensime“, pra shpenzimet e lindura nga vendimet gjyqësore për paga nga ndërprerjet e marrëdhënies së punës dhe detyrimet në llogarinë 604 “Transferime korrente të brendshme”, pra detyrime të rrjedhura nga vendimet e gjykatave për kryesisht kompensim financiar për kthim kompensim prone dhe apo oborre; si dhe shpenzimet gjyqësore; të dy këto llogari të pasqyruara në mënyrë sintetike, mbahen të grupuara analitikisht sipas datës së hyrjes së vendimit në vitin përkatës por nga ana tjetër të kryqëzuara sipas datës së vendimit pra datës së krijimit të detyrimit; dhe nuk bëhet një grupim tjetër me kriterin e fiksimit të vitit si datë hyrje por të klasifikuara vendimet sipas datës së shpallur nga gjykata ( p sh vendime ardhur ne v. 2016, nga këto: hyre ne 2016 që i përkasin v.2013, që i përkasin v.2014, ..v.2015..., vitit 2016), mënyrë kjo që siguron ndjekjen e parimit të kontabilitetit “Hyrja e parë–dalja e parë”, duke bashkërenduar kështu sektori i financës me grupin e trajtimit të vendimeve të gjykatave trajtuar më hollësisht ne procesverbalet nr. 2 dhe nr. 5 përfshirë tabelën përkatëse; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël” (*Trajtuar në faqet 18-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 7:** ATP Tirane, Sektori Financës të marrë masa në organizimin e mbajtjen e evidencës kontabël analitike të detyrimeve mbajtur në llogaritë 6027 “Shpenzime për detyrime për Kompensime“, pra shpenzimet e lindura nga vendimet gjyqësore për paga nga ndërprerjet e marrëdhënies së punës dhe detyrimet në llogarinë 604 “Transferime korrente të brendshme”, pra detyrime të rrjedhura nga vendimet e gjykatave për kryesisht kompensim financiar për kthim kompensim prone dhe apo oborre; si dhe shpenzimet gjyqësore; të dy këto llogari të pasqyruara në mënyrë sintetike, dhe të mbajtura të grupuara analitikisht sipas datës së hyrjes së vendimit në vitin përkatës por nga ana tjetër të kryqëzuara sipas datës së vendimit pra datës së krijimit të detyrimit; të dy këto llogari analitike të grupohen edhe bazuar në kriterin e fiksimit të vitit si datë hyrje duke klasifikuar vendimet sipas datës së shpallur nga gjykata ( p sh vendime ardhur ne v. 2016, nga këto: hyre ne 2016 që i përkasin v.2013, që i përkasin v.2014, v.2015..., vitit 2016), mënyrë kjo që realizon ndjekjen e parimit të kontabilitetit “Hyrja e parë–dalja e parë” në procesin e shlyerjes së detyrimit, nëpërmjet bashkërendimit të sektorit të financës me grupin e trajtimit të vendimeve të gjykatave sipas skemës trajtuar në tabelat përkatëse shoqëruese të procesverbaleve nr. 2 dhe nr. 5.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 8:** ATP Tiranë, Ish-AKKP, për periudhën para v. 2013 e vazhdim deri në vitin 2016 në asnjë dokument të veçantë dhe as në Rregullore nuk ka përcaktuar e përshkruar përshkrimet e punës, “Job Discription“, për pasojë as nuk janë përcaktuar kritere për testimin e pranimin e marrjen në punë dhe për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve dhe gjithashtu në asnjë dokument të veçantë dhe as në Rregulloren “Për Organizimin e Punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave“, aktualisht ende në fuqi miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008, në kundërshtim me pikën 16 të VKM nr. 256, datë 13.4.2010 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ku shprehet se: “...Personeli i AKKP duhet të plotësojë Kërkesat e përgjithshme.... dhe kërkesat e veçanta (të cilat nuk janë

*përcaktuar) të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm ....” dhe në kundërshtim me pikën 18 të VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të ATP”, ku shprehet se: “... Punonjësit e ATP-së, përveç kërkesave të përgjithshme, të përcaktuara në pikën 17, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme të përcaktuara në përshkrimin e punës....”, të cilat mungojnë si cilësimi për kërkesat e posaçme ashtu dhe përcaktimi në përshkrimin e punës të përshkruara e përfshira në Rregulloren e Brendshme dhe që do vendoseshin në Kontratat Individuale të Punës; pra mungojnë vendosja e sistemit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB), mungesa të cilat kanë sjellë pasojë keq menaxhimin e burimeve njerëzore paqëndrueshmërinë e kontratave të punës shoqëruar me dëme ekonomike; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Trajtuar në faqet 19 -24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim 8:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në një dokument të veçantë dhe në Rregullore të përcaktojë e përshkruajë përshkrimet e punës, “Job Discription“ të vendosë e plotësojnë kërkesat e posaçme të përcaktuara në përshkrimin e punës sipas detyrimit në pikën 18 të VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të ATP”, të përcaktojë kritere për testimin pranimit e marrjen në punë dhe për kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve, të munguara deri tani, të cilat ti përfshijë në kontratat individuale të punës si dhe të vendosen dhe zbatohen sistemi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm (SMKB), me synim rritjen menaxhimit të burimeve njerëzore, eliminimin e paqëndrueshmërisë së kontratave të punës dhe të dëmeve ekonomike të rrjedhura prej ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 9:** ATP Tiranë, Ish AKKP, për periudhën para v. 2013 e vazhdim deri në vitin 2016 ka në përdorim Rregulloren “Për Organizimin e Punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave“, aktualisht ende në fuqi, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008, e cila nuk përfshin pikën 16 të VKM nr. 256, datë 13.4.2010 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ku shprehet se: “...Personeli i AKKP duhet të plotësojë Kërkesat e përgjithshme.... dhe kërkesat e veçanta (të cilat nuk janë përcaktuar) të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm ....”. Kjo rregullore e pa përditësuar dhe është jashtë aktualitetit. Me urdhrin nr. 215, datë 07.07.2016 “Për Ngritjen e Grupit të punës për hartimin e rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Punës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave”, Drejtori i përgjithshëm ka urdhëruar ngritjen e grupit të punës të përbërë nga 13 persona për hartimin e Projekt rregullores, shoqëruar me relacionin përkatës dhe me përshkrimet e vendit të punës për çdo sektor, me afat përfundimi deri datë 10.08.2016, urdhër i cili përveç se është i vonuar por nuk është realizuar ende, pasi nuk u paraqit gjatë auditimit një dokument maket; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, me ligjin nr. 133/2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave” me pikën 16 të VKM nr. 256, datë 13.4.2010 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” me pikën 18 të VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të ATP” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” (Trajtuar në faqet 19 -24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 9 :** ATP Tiranë të hartojë dhe miratojë tek Ministri i Drejtësisë Rregulloren e re “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Punës në Agjencinë e Trajtimit të Pronave“, të nisur dhe të papërfunduar në afat datë 10.08.2016 sipas urdhrin nr. 215, datë 07.07.2016 “Për Ngritjen e Grupit të punës për hartimin e rregullores “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Punës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave”.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 10:** ATP Tiranë, Ish-AKKP, ka rezultuar me strukturë të paqëndrueshme të punësuarve, mungesë menaxhimi të burimeve njerëzore dhe të aktivitetit të Njesisë, karakterizuar nga emërimet e shpeshta pa kriter me kohëzgjatje minimale deri me ditë e muaj, për punonjësit e pranuar rishtas, lëvizje të shpeshta brenda sektorëve etj, që kanë sjellë risqe në përmbushjen e funksionit të ATP për periudhën 2013-30.6.2016 dhe përveç sa sipër edhe vështirësi në kryerjen e auditimit, lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe sigurimin e kontaktit ballafaques për problemet eventuale, gjendje kjo në kundërshtim me normat e Kodit të punës, ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, si dhe me formatin tip të kontratës individuale të punës, veprime këto të dokumentuara nga Regjistrat e punonjësve dhe listat e punonjësve të periudhës 2013-2014-2015 dhe 2016 dhe konkretisht:

për vitin 2013, janë emëruar rishtas 65 punonjës ose 71%, ndryshuar sektori për 48 punonjës ose 53%, larguar 37 ose 41 %, vende bosh 10 ose 9,1%, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës të punonjësve emëruar rishtas 7, 20 dite, 1,2,3,4,5,6,7,8,11 muaj,

për vitin 2014, janë emëruar rishtas 94 (9) punonjës ose 71%, 10%, ndryshuar sektori 3 ose 3%, larguar 36(8) ose 40 %, 9%, vende bosh 6-7ose 8%, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës të punonjësve emëruar rishtas 3-9 muaj,

për vitin 2015, janë emëruar rishtas 9 punonjës ose 10%, ndryshuar sektori - , larguar 12 ose 13,2 %, vende bosh 6 ose 6,6%, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës të punonjësve emëruar rishtas 6-18 muaj

për vitin 2016 janë emëruar rishtas – punonjës, ndryshuar sektori ?, larguar 8 ose 8,8 %, vende bosh ?, me kohëzgjatje të marrëdhënies së punës të punonjësve emëruar rishtas 6-27 muaj. Nuk është plotësuar numri 169 sipas organikës së re pas periudhës Maj e vazhdim, pasqyruar në tabelën si vijon:

SRTUKTURA EMËRIMET, LËVIZJET, LARGIMET VENDET BOSH KOHËZGJATJA E TË PUNËSUARVE PËR v. 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

Numri sipas Str.organ sipas viteve	Emërimet	Lëvizjet Ndryshim Sektori	Largimet	Vende Bosh	Kohëzgjatja e Marrëdhënies së punës
v.2013, <b>numri 91</b> Urdh. Nr.70, datë 5.4.2010	65	48	37	10	7,20dite, 1,2,3,4,5,6,7,8,11 muaj
v.2014, <b>numri 91</b> Urdh. Nr.95, datë 21.2.2014	94 (9)	3 (-)	36(8)	7(6)	3muaj-9 muaj
v.2015, <b>numri 91</b> Urdh. Nr.95, datë 21.2.2014	9	-	12	6	6 muaj-18 muaj
v.2016, 4 mujori 91, maj <b>169</b> Urdh. Nr.87, datë 17.5.2016	-(22)	?	(22)8	?	6 muaj-27muaj

*Shënim: Burimi i të dhënave nga regjistrat e punonjësve dhe listë-prezencat përgatitur nga Burimet Njerëzore.*

Struktura faktike e pa qëndrueshme e të punësuarve karakterizuar nga emërimet e shpeshta pa kriter me kohëzgjatje minimale deri me ditë e muaj, lëvizje të shpeshta brenda sektorëve etj, kanë sjellë risqe në trajtimin e marrëdhënies punës, në përmbushjen e funksionit të ATP për periudhën 2013 - 30.6.2016 sikundër përcaktuar në tabelën “SRTUKTURA EMËRIMET, LËVIZJET, LARGIMET VENDET BOSH KOHËZGJATJA E TË PUNËSUARVE PËR v. 2013, 2014, 2015 dhe 2016”; dhe përveç sa sipër edhe vështirësi në kryerjen e auditimit, lidhur me administrimin e dokumentacionit dhe sigurimin e kontaktit ballafaques për problemet eventuale (*Trajtuar në faqet 19 -24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 10:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja e Burimeve Njerëzore të marrë masa për rritjen e shkallës së menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të aktivitetit të Njesisë, për sigurimin e strukturës së qëndrueshme të punësuarve sipas organigrames nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të kriteve të posaçme dhe të përfshihen në kontratat individuale dhe kolektive të punës,

kufizimit të emërimeve të shpeshta pa kriter me kohëzgjatje minimale deri me ditë e muaj, për punonjësit e pranuar rishtas dhe eliminimin e lëvizjeve të shpeshta brenda sektorëve etj, me synim shmangien e risqeve nga faktorët e lidhur me drejtimin e administrimit të dokumentacionit pronësor dhe në përmbushjen e funksionit, qëllimit, misionit dhe objektivave të ATP-së, sikundër përcaktuar në tabelën emërtuar “SRTUKTURA EMËRIMET, LËVIZJET, LARGIMET VENDET BOSH KOHËZGJATJA E TË PUNËSUARVE PËR v. 2013, 2014, 2015 dhe 2016”.

### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**Gjetje 11:** Në ATP/AKKP për periudhën para viteve deri Tetor 2013 dhe periudhën vitin 2013, 2014, 2015 deri 30.06.2016, për atakim të vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash kanë ardhur **190 vendime Gjykatash** që kanë prodhuar detyrime, të cilat cenojnë fondin e kompensimit, sjellin mbishpenëzim për buxhetin e ATP dhe të buxhetit të shtetit, për **190 vendime** me vlerën totale **379,989 mijë lekë** nga e cila **289,763 mijë lekë** për vlerën e kompensim–kthimit **11, 916 mijë lekë** për tarifë shërbimi dhe **6,900 mijë lekë** shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar **137,663 mijë lekë**, mbetur **170,915 mijë lekë** (në fakt detyrimi i mbetur duhet të jetë jo 170, 915 mijë lekë, por 242,326 mijë lekë (379,989 mijë-137,663 mijë lekë) mos rakordim i rrjedhur nga evidenca “Vendimet e Gjykatave të Ekzekutuara në vitin 2014-2016”, për të cilin mban përgjegjësi Komisioni përcaktuar me Urdhrat nr. 416, datë 18.12.2014 dhe urdhrin nr. 12, datë 09.01.2015”, “Për Ngritjen e Grupit të Punës për Kryerjen e Procedurave të Ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësore për Kompensimin Financiar”, ndryshuar me urdhrin nr. 193, datë 09.09.2015), që gërryejnë, rëndojnë fondin e kompensimit, sjellin mbishpenzim për buxhetin e ATP dhe të buxhetit të shtetit, në kundërshtim me **ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”** dhe me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin e Shlyerjeve të Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 11,12 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 **“Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, me nenet 7, 8, 9 të Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015 “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave, që ngarkon me përgjegjësi për mos analizim dhe nxjerrje përgjegjësie për vendimet e mara nga ish-AKKP dhe ATP, dhe të atakuara nga Vendimet e gjykatave, ndaj personave të grupeve të punës për shqyrtimin e Vendimeve të Gjykatave si dhe përkatësisht Drejtorët e Përgjithshëm, Zv. Drejtorët e Përgjithshëm pasqyruar** në tabelat emërtuar “Vendimet Gjyqësore 2014-2016 në atakim të vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash me 5 fletë”, tabelën emërtuar “Përmbledhëse e Detyrimeve nga Vendimet e Gjykatave për Atakimin e Vendimeve për kthim dhe kryesisht për kompensim të marra nga ish-AKKP dhe ATP, sipas kohës së Krijimit dhe likuidimet për periudhën 2014-30.06.2016 me 3 fletë”(Trajtuar në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 11:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm me strukturat përkatëse (Grupin e Punës dhe Sektorin e Financës), të marrin masa të analizojnë, nxjerrin përgjegjësinë dhe të ndjekin procedurat ligjore për zhdëmtim e vlerave të detyrimeve dhe mbi shpenzimit rrjedhur nga atakimi i vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash për **190 vendime Gjykatash** që kanë prodhuar detyrime, të cilat rëndojnë, fondin e kompensimit, sjellin mbishpenëzim për buxhetin e ATP dhe buxhetin e shtetit, për **190 vendime** me vlerën totale **379,989 mijë lekë** nga e cila **289,763 mijë lekë** për vlerën e kompensim–kthimit **11, 916 mijë lekë** për tarifë shërbimi dhe **6,900 mijë lekë** shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar **137,663 mijë lekë**, mbetur **170,915 mijë lekë** (në fakt detyrimi i mbetur duhet të jetë jo 170, 915 mijë lekë, por 242,326 mijë lekë (379,989 mijë-137,663 mijë lekë), pasqyruar në tabelat emërtuar “Vendimet Gjyqësore 2014-2016 në atakim të vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash me 5 fletë” dhe tabelën emërtuar “Përmbledhëse e Detyrimeve nga Vendimet e

Gjykatave për Atakimin e Vendimeve për kthim dhe kryesisht për kompensim të marra nga ish-AKKP dhe ATP, sipas kohës së Krijimit dhe likuidimet për periudhën 2014-30.06.2016 me 3 fletë”.

**Menjëherë**

**Gjetje 12:** Detyrimet nga vendimet e gjykatave për periudhën para viteve 2013, vitin 2013, 2014, 2015 dhe deri 30.06.2016, për atakim të vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash sipas periudhave të ushtrimit të detyrës nga titullarët dhe ish punonjësit e punonjësit aktual ndahen:

**2. a.-**Për periudhën para v. 2012 deri 9.10.2013 ish-AKKP me titullar **z. A P**, për **106 vendime vlerën totale 161,608 mijë lekë nga e cila 93,677 mijë lekë për vlerën e kompensim–kthimit, 3,436 mijë lekë për tarifë shërbimi dhe 2,803 mijë lekë shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar 77,510 mijë lekë (përkatësisht pas vitit 2014), mbetur 12,687 mijë lekë**

**2. b.-**Për periudhën **10.10.13-30.6. 2016 nga ATP me titullar znj. S Q**, detyrimet janë rritur gati **1,35 herë krahasuar me periudhën para deri 10 Tetor 2013; pra janë krijuar për 84 vendime vlerën totale 218,381 mijë lekë përkatësisht (në 10.10.-31.12.13 për 17 vendime me lerë 9,388 mijë lekë, v. 2014 për 51 vendime me vlerë 189,642 mijë lekë, ne v. 2015 për 14 vendime me vlerë 15,016 mijë lekë dhe v. 2016 për 2 vendime me vlerë 4,342 mijë lekë), nga të cilat: 196,086 mijë lekë për vlerën e kompensim–kthimit, (përkatësisht ne vite.... ), 8,480 mijë lekë për tarifë shërbimi (përkatësisht në vite) dhe 4097mijë lekë shpenzime gjyqësore (përkatësisht ne vite), nga të cilat janë likuiduar 27 vendime me 60,153 mijë lekë (përkatësisht pas vitit 2014), mbetur 158,228 mijë lekë për **57 vendime**, paraqitur në tabelën emërtuar “Përmbledhëse e Detyrimeve nga Vendimet e Gjykatave për Atakimin e Vendimeve për kthim dhe kryesisht për kompensim të marra nga ish-AKKP dhe ATP, sipas kohës së Krijimit dhe likuidimet për periudhën 2014-30.06.2016”, bashkëlidhur (Trajtuar në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**Rekomandim 12:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm strukturat përkatëse (Grupin e Punës dhe Sektori i Financës), të marrin masa të rakordojnë korrigjojnë e saktësojnë detyrimin e mbetur për 242,326 **mijë lekë** (në fakt detyrimi i mbetur duhet të jetë jo 170, 915 mijë lekë, por 242,326 mijë lekë (379,989 mijë-137,663 mijë lekë) sipas tabelave “Vendimet e Gjykatave të Ekzekutuara në vitin 2014-2016”, “Përmbledhëse e Detyrimeve nga Vendimet e Gjykatave për Atakimin e Vendimeve për kthim dhe kryesisht për kompensim të marra nga ish-AKKP dhe ATP, sipas kohës së Krijimit dhe likuidimet për periudhën 2014-30.06.2016”; si dhe të pasqyrohet saktësisht në llogarinë përkatëse të kontabilitetit nga Sektori i Financës.

**Menjëherë**

**Gjetje 13:** ATP Tiranë nuk ka një mbajtje llogarie apo dixhitalizim, tabelë për 190 vendime Gjykatash që kanë prodhuar detyrime, që rëndojnë fondin e kompensimit, sjellin dëm ekonomik për buxhetin e ATP dhe të buxhetit të shtetit, për 190 vendime me vlerën totale 379,989 mijë lekë nga e cila 289,763 mijë lekë për vlerën e kompensim–kthimit 11,916 mijë lekë për tarifë shërbimi dhe 6,900 mijë lekë shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar 137,663 mijë lekë, mbetur 170,915 mijë lekë ku të mund të evidentohen dhe ose të saktësohen e përkthehen në sipërfaqet përkatëse fizike të zbritshme nga vendimet e njohura dhëne ATP pronarëve lidhur me të dhënat:

**a.** Për ç sipërfaqe të njohur nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime (nga 190), për sa vendime të ATP të atakuara (prej 190), si dhe për çfarë vlere,

**b.** Për ç sipërfaqe të njohur për tu kthyer nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP, si dhe për çfarë vlere,

**c.** Për ç sipërfaqe të njohur për tu kompensuar fizikisht nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP si dhe për çfarë vlere,

**d.** Për ç sipërfaqe të njohur për tu kompensuar financiarisht nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP si dhe për çfarë vlere,

e. Lidhur me të dhënat për sa vendime të AKKP të konsideruara të rregullta nga ATP gjykata në ... vendime është shprehur kundër tyre përkatësisht për... vendime të ATP me ... vlerë lekë.

f. Lidhur me të dhënat për kundërshtimet e vendimeve të AKKP/ATP nga pronarët/trashëgimtarët, nga Avokati Shtetit apo palët e interesuara, sa vendime (prej 190 vendimeve) janë kundërshtuar nga secila kategori shprehur me treguesit përkatës që do të shërbente rritjes së shkallës së administrimit ruajtjes dhe menaxhimit të fondeve financiare e fizike si dhe zbatimin e buxhetit; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, në kundërshtim me **ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me UMF nr. 30, datë 27.12.2011** “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin e Shlyerjeve të Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 11,12 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “**Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës**”, i ndryshuar, me **nenet 7, 8, 9 të Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015**, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, me VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016, “Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (Trajtuar në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 13:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm, me strukturat përkatëse të marrë masa të evidentojë e mbajtje llogarie apo dixhitalizojë, tabelojë 190 vendimet Gjyqësore që kanë prodhuar detyrime në fondin e kompensimit, buxhetin e ATP dhe buxhetin e shtetit, për 190 vendime me vlerën totale 379,989 mijë lekë nga e cila 289,763 mijë lekë për vlerën e kompensim–kthimit 11,916 mijë lekë për tarifë shërbimi dhe 6,900 mijë lekë shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar 137,663 mijë lekë, mbetur 170,915 mijë lekë ku të mund të evidentohen dhe ose të saktësohen e përkthehen në sipërfaqet përkatëse fizike të zbritshme nga vendimet e njohura dhëne ATP pronarëve lidhur me të dhënat:

a. Për ç sipërfaqe të njohur nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime (nga 190), për sa vendime të ATP të atakuara (prej 190), si dhe për çfarë vlere,

b. Për ç sipërfaqe të njohur për tu kthyer nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP, si dhe për çfarë vlere,

c. Për ç sipërfaqe të njohur për tu kompensuar fizikisht nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP si dhe për çfarë vlere,

d. Për ç sipërfaqe të njohur për tu kompensuar financiarisht nga ATP, gjykata ka vendosur kompensim financiar me sa vendime, dhe për sa vendime të ATP si dhe për çfarë vlere,

e. Lidhur me të dhënat për sa vendime të AKKP të konsideruara të rregullta nga ATP gjykata në ... vendime është shprehur kundër tyre përkatësisht për... vendime të ATP me ... vlerë lekë.

f. Lidhur me të dhënat për kundërshtimet e vendimeve të AKKP/ATP nga pronarët/trashëgimtarët, nga Avokati Shtetit apo palët e interesuara, sa vendime (prej 190 vendimeve) janë kundërshtuar nga secila kategori shprehur me treguesit përkatës me synim në përmbushje të funksionit rritjen e shkallës së menaxhimit sigurimin e administrimit e ruajtjes dhe mirë përdorimit të fondeve financiare e fizike si dhe zbatimin e buxhetit.

### **Menjëherë dhe në Vazhdimësi**

**Gjetje 14:** ATP nuk ka dokumentuar, analizuar shkaqet e nxjerrë përgjegjësinë dhe marrë masat lidhur me Vendimet e gjykatave, ardhur në atakim të vendimeve të ATP/AKKP, përpara se ato të urdhëroheshin për likuidim, në gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr 9228, datë 29.4.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe me VKM nr. 50, datë 5.2.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin e Shlyerjeve të Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”, gjendje kjo në kundërshtim me nenin 11,12 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “**Për**

**Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, me nenet 7,8,9 të Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, me VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016, “Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” (Trajtuar në faqet 24-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**Rekomandim 14:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm, Drejtorja Juridike dhe Sektori i Financës të dokumentojë, analizojë shkaqet e nxjerrë përgjegjësinë dhe të marrë masat e duhura ligjore si dhe pasqyrojë pasojat financiare në Buxhetet përkatëse lidhur me Vendimet e gjykatave, ardhur në atakim të vendimeve të ATP/AKKP , përpara se ato të urdhërohen për likuidim.

#### **Menjëherë dhe në Vazhdimësi**

**Gjetje 15:** ish-AKKP dhe ATP për periudhën para vitit 2013 deri 30.6.2016 ka pamjaftueshmëri pune lidhur me krijimin, mos menaxhimin, marrjen dhe vënien nën administrim, mos **evidentimin në data base funksional** dhe mos marrjen e masave për përdorimin e Fondit për kompensim fizik të ish-pronarëve të **157 objekteve me sipërfaqe totale trualli 250 051 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 84 863 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 177 587 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 2,103, 876, 644 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **1,175,311,447 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **928,545,227 lekë vlerë trualli** në momentin e vlerësimit; gjendje kjo në kundërshtim me **ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik**”, me nenin 28 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 **“Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr. 133, datë 05.12.2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, me VKM nr 257, datë 11.04.2007 “Për Kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”si dhe me VKM-së nr. 223, datë 23.03.2016, “Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” “kreu III, pika 86 dhe Kreu IV në vijim, pasqyruar në tabelën analitike “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve me 7 fletë” dhe në tabelën përmbledhëse sipas viteve të krijimit emërtuar “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve 2009-30.06.2016”**, për periudhën para vitit 2013 deri 30.6.2016 ka pamjaftueshmëri pune lidhur me krijimin, mos përdorimin e fondit të kompensimit fizik të 150 objekteve dhe trojet përkatëse (Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 15:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori përkatës të marrin masa për menaxhimin, marrjen dhe vënien nën administrim të fondit të krijuar e papërdorur prej mbi 6 vjetësh, vazhdimin e procedurave në përdorimin e Fondit për kompensim fizik të ish-pronarëve të **157 objekteve me sipërfaqe totale trualli 250 051 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 84 863 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 177 587 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 2,103, 876, 644 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **1,175,311,447 lekë, vlera ndërtimore** e objekteve dhe **928,545,227 lekë vlerë trualli** në momentin e vlerësimit, pasqyruar në tabelën analitike “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve me 7 fletë” dhe tabelën përmbledhëse sipas viteve të krijimit emërtuar “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve 2009-30.06.2016”.

#### **Menjëherë**

**Gjetje 16 :** ATP Tiranë, ish-AKKP prej para viteve 2013 dhe në vitin 2014, 2015 deri 6/mujorin e I-rë 2016 ka pamjaftueshmëri, mungesë llogaritjesh apo bilanci të nevojave për objektet e lira në krijimin e FKF, mungesë plan-veprime strategji, lidhur me krijimin përdorimin e Fondit vënë në dispozicion i cili rezulton i pamjaftueshëm jo real dhe i mundshëm, me numër të kufizuar dhe në rënie përkatësisht sipas viteve: në vitin 2009 janë 51 objekte ose 32 %, vitin 2010 janë 1 objekt ose >1 %, në vitin 2011 janë 34 objekte ose 22 %, në vitin 2012 janë 42 objekte ose 27 %, në vitin 2013 janë 4 objekte ose 3 %, në vitin 2014 janë 18 objekte ose 11 %, në vitin 2015 asnjë objekt dhe 6 mujorin e I 2016, 7 objekte ose 4 % , që tregon mungesë bashkëpunimi nga ministrinë

dhe organet e NJQV-ve me ATP për identifikimin dhe vënien në dispozicion të objekteve trojeve pasurive të ndodhura nën administrimin e ish ndërmarrjeve të ministrive përkatëse dhe në juridiksion territorial të ish-NjQV-ve, aktualisht të Bashkive dhe të përshkruara në listat paraprake dhe listat përfundimtare të pronave të bashkive, pasqyruar në tabelën “**Tabela përmbledhëse e objekteve për kompensim fizik sipas viteve të krijimit dhe struktura**”, me synim rritjen e **fondit të kompensimit fizik në zbutje të fondeve financiare të kompensimit** (Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 16:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të bashkëpunojnë me ministrinë dhe organet e NJQV-ve për identifikimin dhe vënien në dispozicion të objekteve trojeve pasurive të ndodhura nën administrimin e ish ndërmarrjeve të ministrive përkatëse dhe në juridiksion territorial të ish-NjQV-ve, aktualisht të Bashkive dhe të përshkruara në listat paraprake dhe listat përfundimtare të pronave të bashkive, **me synim rritjen e fondit të kompensimit fizik në zbutje të fondeve financiare të kompensimit.**

#### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 17:** Në vitet 2015-2016 janë kthyer nga ATP, sipas kërkesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) Tiranë, Fondi i kompensimit Fizik në Objekte **është pakësuar** për 9 objekte me 25420 m<sup>2</sup> truall, me 10213 m<sup>2</sup> sipërfaqe ndërtimi objektesh me vlerë totale 139,4 milion lekë, kthyer përkatësisht sipas periudhave; 6 objekte në vitin 2015 me sipërfaqe trualli 24910 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 9703 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 132,8 milionë lekë; 3 objekte në 6 mujin I vitin 2016 me sipërfaqe trualli 510 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 510 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 6,7 milionë lekë, sipas VKM nr. 926, datë 29.12.2014 “Për Kriteret e Vlerësimit të Pronës Shtetërore që Privatizohet apo Transformohet dhe procedurën e Shitjes”, kapitulli III, pika 18, germa “a”, paragrafi i dytë, ku përcaktohet se: “... Në rast se për objektin, dokumentacioni i të cilit është kthyer për tu përdorur si fond kompensimi fizik, ku kërkesa me shkrim nga ish-pronarët e truallit, ministria përgjegjëse për ekonominë i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kthimin e dokumentacionit të Vlerësimit, pasi kjo e fundit të ketë bërë verifikimin e vlefshmërisë së vendimit që njeh pronësinë ...” Ky fond kompensimi fizik i objekteve i pakësuar nuk është përdorur në destinacionin e caktuar përkatësisht prej vitit 2009 për 4 objekte v. 2011-2012 për 2 objekte prej vitit 2011-2012 dhe 2 objekte prej v. 2014 për të cilat nuk është vepruar për një periudhë prej 1-7 vjetësh nga marrja nga AKKP, dhe ATP në administrim të këtij dokumentacioni.

Gjithashtu nga ana e ATP pas kthimit të dokumentacionit për 9 objektet nuk ka një korrespondencë me MZHETTS Tiranë lidhur me truallin e përfutur si fond kompensimi në parablerje të objekteve nga ish pronarët për sipërfaqen totale trualli **13 955.7 m<sup>2</sup>** që u përket **7 Vendimeve përkatësisht: nr. 946, datë 07.07 1995** ish- KKKP Korçë, (me truall të përgjithshëm të objektit **1215 m<sup>2</sup>**); EMF;-; **nr. 325, datë 30.08 1996** ish- KKKP Berat, (me truall të përgjithshëm të objektit **800 m<sup>2</sup>**); (fond banese 1630 m<sup>2</sup>); **nr. 862, datë 28.07.2008** ish-AKKP Tiranë, (me truall të përgjithshëm të objekteve **11 328 m<sup>2</sup>**); **nr. 84, datë 09.07 1998** ish- KKKP Këshillit Rrethit Dibër, (me truall të përgjithshëm të objekteve **102 m<sup>2</sup>**); **nr. 33, datë 21.07 1995**, ish-KKKP Bashki Burrel, (me truall të përgjithshëm të 2 objekteve **345,85 m<sup>2</sup> { 160 +185,85 }**); të verifikuara dhe konfirmuara për vlefshmërinë nga ATP dhe Vendimit **nr. 99, datë 25.07 1994** ish-KKKP Bashkia Krujë, (me truall të përgjithshëm të 9 objekteve **164,5 m<sup>2</sup>**), për të cilin ATP është shprehur se nuk e administron në arkiv. ATP nuk ka një DTB evidencë të sipërfaqeve të truallit prej **13 955.7 m<sup>2</sup>** të kthyer fizikisht nga parablerja e objekteve nga ish-pronarët të cilëve u është njohur sipërfaqja (Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 17:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të marrë masa të bashkëpunojnë dhe informohet për kontratat e shitjes ish pronarëve të objekteve kthyer tek MZHETTS Tiranë në v. 2015-2016, evidentimin dhe zbutjen si kthim fizik në DTB të sipërfaqeve totale të truallit prej **13 955.7 m<sup>2</sup>** që u përket 7 vendimeve përkatësisht: nr. 946, datë 07.07 1995

ish-KKKP Korçë, (me truall të përgjithshëm të objekteve 1215 m<sup>2</sup>); EMFI,-; nr. 325, datë 30.08 1996 ish- KKKP Berat, (me truall të përgjithshëm të objekteve 800 m<sup>2</sup>); (fond banese 1630 m<sup>2</sup>); nr. 862, datë 28.07 2008 ish AKKP Tiranë, (me truall të përgjithshëm të objekteve 11 328 m<sup>2</sup>); nr. 84, datë 09.07 1998 ish- KKKP Këshillit Rrethit Dibër, (me truall të përgjithshëm të objektit 102 m<sup>2</sup>); nr. 33, datë 21.07 1995 ish-KKKP Bashki Burrel, (me truall të përgjithshëm të 2 objekteve me 345,85 m<sup>2</sup>{160 +185,85}); të verifikuara dhe konfirmuara për vlefshmërinë nga ATP dhe Vendimit nr. 99, datë 25.07 1994 ish-KKKP Bashkia Krujë, (me truall të përgjithshëm të 9 objekte kapanone 164,5 m<sup>2</sup>), për të cilin ATP është shprehur se vendimin nuk e administron në arkiv; si dhe krijimi i një database, DTB evidencë për sipërfaqet troje, pasuri të ndryshme të kthyera fizikisht nga parablerja e objekteve nga ish-pronarët të cilëve u është njohur sipërfaqja.

### Menjëherë dhe në vazhdimësi

**Gjetje 18:** ATP Tiranë, ish-AKKP prej viteve 2009 deri 30.06.2016 nuk ka vepruar pra nuk ka asnjë praktikë dokumentare dhe nuk është zhvilluar asnjë procedurë ankandi për vënien në destinacion përdorimi të *Fondit Kompensimi Fizik përbërë prej listës së 157 objekte me sipërfaqe totale trualli 250 051 m<sup>2</sup>* nga e cila sipërfaqe nën *objekte 84 863 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 177 587 m<sup>2</sup>*, me vlerë të objekteve *prej 2,103,876,644 lekë*, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: *1,175,311,447 lekë, vlera ndërtimore* e objekteve dhe *928,545,227 lekë vlerë trualli* në momentin e vlerësimit; gjendje kjo në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, nenin 37 të Ligjit nr. 133, datë 05.12.2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, me VKM nr 257, datë 11.04.2007 “Për Kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore, të subjekteve të shpronësuar në disa raste të veçanta” si dhe me VKM-së nr. 223, dt 23.03.2016, “Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave” ‘kreu III, pika 86 dhe Kreu IV në vijim; pasqyruar në tabelën analitike “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve me 7 fletë” dhe në tabelën përmbledhëse sipas viteve të krijimit emërtuar “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve 2009-30.06.2016” (Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim 18:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të marrë masa për zhvillimin e procedurës ankandit për vënien në destinacion përdorimi të Fondit Kompensimi Fizik, përbërë prej *listës së 157 objekteve të publikuara në Vebside, me sipërfaqe totale trualli 250 051 m<sup>2</sup>* nga e cila sipërfaqe nën *objekte 84 863 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 177 587 m<sup>2</sup>*, me vlerë të objekteve *prej 2,103,876,644 lekë*, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: *1,175,311,447 lekë, vlera ndërtimore* e objekteve dhe *928,545,227 lekë vlerë trualli* në momentin e vlerësimit pasqyruar në tabelën analitike “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve me 7 fletë” dhe në tabelën përmbledhëse sipas viteve të krijimit emërtuar “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve 2009-30.06.2016”.

### Menjëherë

**Gjetje 19:** \*Nga Drejtori i Përgjithshëm dhe stafi përkatës i mëparshëm i AKKP-së për periudhën deri në v. 2013 si dhe nga Drejtori i Përgjithshëm e stafi aktual i ATP-së për periudhën 2013-dhjetor 2015, përveç se nuk është vepruar për ankandin e objekteve, por ka munguar dhe menaxhimi, marrja, vënia nën administrim e objekteve dhe ka munguar kryerja e identifikimit të gjendjes juridike reale e fizike, për 157 Objekteve të Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve” vënë në destinacion.

\*Kanë munguar vendosje, përcaktimi, normimi i një sistemi rregullash ndërmjet ATP (ish AKKP) me institucionet (Ministritë, Bashkitë etj) që kanë pasur ose kanë nën administrim objektet e vëna në dispozicion (pra që me shkresë i delegohen ATP për trajtim fondi kompensimi fizik) lidhur me dorëzimin marrjen në dorëzim dhe vënien nën administrim ruajtjen e objekteve gjatë procesit pas

dorëzimit të dokumentacionit deri në përfundimin e procesit të kompensimit pra dorëzimit tek fituesi i titullit të pronësisë; gjendje kjo në kundërshtim me *ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*, me nenin 28 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr. 133, datë 05.12.2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”*, me VKM nr 257, datë 11.04.2007 *“Për Kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore , të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”*si dhe me VKM-së nr. 223, dt 23.03.2016, *“Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”* ‘kreu III, pika 86 dhe Kreu IV në vijim.

ATP (pasi nga ish AKKP, nuk rezulton të ketë ndonjë dokument kërkesë ndaj ZVRPP-ve përkatëse për identifikimin konfirmimin e gjendjes juridike reale të këtyre pasurive), *ka marrë konfirmimet përkatëse të gjendjeve juridike për 68 objekte (10 të vitit 2013, 53 të vitit 2014 dhe 5 të vitit 2015) gjendjeve juridike ta objekteve për të cilat, do të duhej që këto dokumente të shprehnin apo kërkonin bllokimin e pasurive në favor të ATP së cilës prej vitesh i janë vene ne dispozicion si fond kompensimi fizik.* Gjithashtu për identifikimin, konfirmimin e gjendjes juridike reale të këtyre pasurive pas njoftimeve shkresore të vënies ne dispozicion të ATP të këtyre objekteve dhe nuk ka asnjë dokument, – kërkesë ndaj Njësive të Qeverisjes Vendore në juridiksion të cilave ndodhen objektet apo dhe ndaj subjekteve të tjera të cilat i kanë pasur në administrim për gjendjen reale të posedimit të tyre, me synim që për këto pasuri të sigurohet qenia e tyre jo vetëm juridikisht por dhe faktikisht e lirë nga posedues të tjerë (*Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 19:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të marrë masa për menaxhimin, marrjen, vënien nën administrim të objekteve dhe kryerjen e identifikimit te gjendjes juridike reale e fizike, **për 157 Objekte të Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve” vënë në destinacion,** të marrin masa për hartimin, vendosjen, përcaktimin dhe normimin e një sistemi rregullash ndërmjet ATP (ish AKKP) me institucionet (Ministritë, Bashkitë etj) që kanë pasur ose kanë nën administrim objektet e vëna në dispozicion (pra që me shkresë i delegohen ATP për trajtim fondi kompensimi fizik) lidhur me dorëzimin marrjen në dorëzim dhe vënien nën administrim ruajtjen e objekteve gjatë procesit pas dorëzimit të dokumentacionit deri në përfundimin e procesit të kompensimit pra dorëzimit tek fituesi i titullit të pronësisë, si dhe tu kërkojë zyrtarisht ndaj ZVRPP-ve përkatëse bllokimin si dhe ndaj Njësive të Qeverisjes Vendore në juridiksion të cilave ndodhen objektet apo dhe ndaj subjekteve të tjera të cilat i kanë pasur në administrim për gjendjen reale të posedimit të tyre, me synim që për këto pasuri të sigurohet qenia e tyre jo vetëm juridikisht por dhe faktikisht e lirë nga posedues të tjerë; pra identifikimin konfirmimin e gjendjes juridike reale të këtyre pasurive pas njoftimeve shkresore të vënies ne dispozicion të ATP të këtyre objekteve, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”*,

**Menjëherë**

**Gjetje 20:** Në ATP Tiranë nga auditimi i *150 aktverifikimeve dhe relacionit përkatës,* të mbajtura në Dhjetor 2015-10 shkurt 2016 për 150 objektet, nga grupi i punës prej 7 personash të dhënat e të cilave gjatë periudhës së auditimit u renditën me problematikat në tabelën emërtuar “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e pronave dhe problematikat sipas aktverifikimeve”, u grupuan problematikat, paraqitur në tabelën emërtuar “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronave me Problematikat Grupuar”, për të cilat ATP do të duhej të kish vepruar e marrë masat për administrimin e gjendjen e **97 objekteve (prej 150 total)** si më poshtë:

- a. **Për 35 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohet *që përdoren për banesë të zaptuara ose me dokumente*, me sipërfaqe totale trualli **63108 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **19194 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **43915 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **548,572,050 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **273,337,346 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **275,234,704 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka kërkuar pranë NJQV-ve dhe Ministrisë përkatëse (METE, MZHETTS Tiranë) identifikimin e personave posedues, dokumentacionin nëse disponojnë për fond banesë nga NjQV-të, lirim të tyre nga personat përdorues të paligjshëm, verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike sipas faktit më sipër,
- b. **Për 5 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohen të privatizuar, me sipërfaqe totale trualli **5058 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **1197 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **3862 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **63,604,915 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **41,813,275 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **21,791,640 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka kërkuar pranë Ministrisë përkatëse (METE, MZHETTS Tiranë) kontratat përkatëse identifikimin e personave blerës dhe verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike, apo dhe regjistrimit ose jo të kontratës së blerjes,
- c. **Për 6 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohet të zaptuara nga pretenduesit si pronar trualli, me sipërfaqe totale trualli **17249 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **9998 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **7251 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **249,567,720 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **115,653,511 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **133,914,209 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka identifikuar personat posedues (zaptues) dhe nuk ka identifikuar në arkivin e ATP nëse disponojnë Vendime mbi njohjen apo pronësinë e truallit, që ka krijuar pamundësinë e vazhdimin të procedurave për kërkimin e lirit dhe përdorimin si fond kompensimi fizik, si dhe verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike sipas faktit të mësipërm, apo dhe regjistrimit ose jo të titullit të pronësisë,
- d. **Për 26 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohen të amortizuara si vlerë ndërtimore, me sipërfaqe totale trualli **83 581m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **21369m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **65 651m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **457,879,444 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **296,854,502 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **161,024,941 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka kërkuar dhe nuk ka marrë masa dhe për të kërkuar nga institucionet përkatëse ministria dërguese vlerësimin real të vlerës ndërtimore të objekteve të amortizuara,
- e. **Për 8 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohen se nuk ekzistojnë si ndërtesa, me sipërfaqe totale trualli **83 581m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **21369m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **65 651m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **457,879,444 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **296,854,502 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **161,024,941 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka marrë masa për të kërkuar nga institucionet përkatëse ministria dërguese vlerësimin real të vlerës ndërtimore të objekteve të amortizuara që nuk ekzistojnë,
- f. **Për 11 objekte**, të zaptuara pa titull pronësie për të cilat nga verifikimi pretendohet se përdoren për aktivitet tregtar me sipërfaqe totale trualli **10214 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **3626 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **6 588 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **117,938,672 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **43,468,108 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **74,470,564 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka kërkuar pranë NJQV-ve verifikimin për dhënie leje ndërtimi të objekteve, në ZVRPP-të përkatëse identifikimin e gjendjes juridike të pasurive ndërtesa ekzistuese të zaptuara e përshtatura për aktivitete biznesi, dhe gjendjes juridike të trojeve përkatës si dhe nuk ka kërkuar në rrugë ligjore në institucionet përkatëse ministria dërguese dhe nga personat zhdëmtimin e dëmit në vlerën prej **43,468,108 lekë vlera ndërtimore** e objekteve të zaptuara mbi të cilat është tjetërsuar me ndërtime.
- g. **Për 5 objekte**, për të cilat nga verifikimi pretendohet se përdoren si zyra nga Institucione Shtetërore me sipërfaqe totale trualli **2517 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën *objekte* **999 m<sup>2</sup>**, sipërfaqe funksionale **1 518 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve prej **23,116,539 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga

e cila: **17,236,739 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **5,879,800 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka kërkuar e vënë në dijeni institucionet zyrtare, NJQV-të që i posedojnë, ministrinë përkatëse të dërgimit me shkresë..

**h. Për 1 objekt**, për të cilin nga verifikimi pretendohet se është i hipotekuar, me sipërfaqe **totale trualli 236 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 206 m<sup>2</sup>**, **sipërfaqe funksionale 30 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 6,830,591 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **3,296,591 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **3,534,000 lekë vlerë trualli**, ATP nuk ka identifikuar hipotekën, personin, në ZVRPP, nuk ka dërguar dokumentin përkatës pranë ministrisë, dhe mbi këto fakte nuk ka kërkuar heqjen nga fondi i kompensimit fizik të këtij objekti si dhe nuk ka bërë sistemimin dhe evidentimin e truallit nëse personi përfitues, posedues zotëron një Vendim nga AKKP, ATP; pasqyruar analitikisht në tabelat emërtuar “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve sipas viteve 2009-30.6.2016 me 7 flete”, “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve të Krijimit dhe Struktura 1 fletë”, “Objektet(157) e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronave me Problematikat me 5 fletë”, “Objektet(97) e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronave me Problematikat Grupuar me 3 fletë”; gjendje kjo në kundërshtim me **ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”**, me nenin 28 të ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 **“Për Kthimin dhe Kompensimin e pronës”, i ndryshuar, nenin 37 të ligjit nr. 133, datë 05.12.2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, me VKM nr 257, datë 11.04.2007 “Për Kriteret dhe procedurën e kompensimit fizik me troje shtetërore , të subjekteve të shpronësuara në disa raste të veçanta”**si dhe me VKM-së nr. 223, dt 23.03.2016, **“Për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”** ‘kreu III, pika 86 dhe Kreu IV në vijim (*Trajtuar në faqet 66-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 20:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Strukturat përkatëse të marrë masa për administrimin e **97 objekteve** si më poshtë:

**a. Për 35 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohet **që përdoren për banesë të zaptuara ose me dokumente**, me sipërfaqe **totale trualli 63 108 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 19 194 m<sup>2</sup>**, **sipërfaqe funksionale 43 915 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 548,572,050 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **273,337,346 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **275,234,704 lekë vlerë trualli**, ATP **të kërkojë pranë NJQV-ve dhe Ministrisë përkatëse (METE, MZHETTS Tiranë) identifikimin e personave posedues, dokumentacionin nëse disponojnë për fond banese nga NjQV-të, lirimin e tyre nga personat përdorues të paligjshëm, verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike sipas faktit të mësipërm,**

**b. Për 5 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohen të **privatizuar**, me sipërfaqe **totale trualli 5 058 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 1197 m<sup>2</sup>**, **sipërfaqe funksionale 3862 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 63,604,915 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **41,813,275 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **21,791,640 lekë vlerë trualli**, ATP **të kërkojë pranë Ministrisë përkatëse (METE, MZHETTS Tiranë) kontratat përkatëse identifikimin e personave blerës dhe verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike sipas faktit të mësipërm, apo dhe regjistrimit ose jo të kontratës së blerjes,**

**c. Për 6 objekte**, të cilat nga verifikimi pretendohet të **zaptuara nga pretenduesit si pronar trualli**, me sipërfaqe **totale trualli 17 249 m<sup>2</sup>** nga e cila sipërfaqe nën **objekte 9 998 m<sup>2</sup>**, **sipërfaqe funksionale 7251 m<sup>2</sup>**, me vlerë të objekteve **prej 249,567,720 lekë**, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: **115,653,511 lekë vlera ndërtimore** e objekteve dhe **133,914,209 lekë vlerë trualli**, ATP **të identifikojë personat posedues (zaptues) dhe të identifikojë në arkivin e ATP nëse disponojnë Vendime mbi njohjen apo pronësinë e truallit, që ka krijuar pamundësinë e vazhdimit të procedurave për kërkimin e lirit dhe përdorimin si fond kompensimi fizik, si dhe të kërkojë**

*verifikimin në ZVRPP-të përkatëse të gjendjes juridike sipas faktit të mësipërm, apo dhe regjistrimit ose jo të titullit të pronësisë,*

d. *Për 26 objekte, të cilat nga verifikimi pretendohen të amortizuara si vlerë ndërtimore, me sipërfaqe totale trualli 83 581m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe nën objekte 21369m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 65 651m<sup>2</sup>, me vlerë të objekteve prej 457,879,444 lekë, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: 296,854,502 lekë vlera ndërtimore e objekteve dhe 161,024,941 lekë vlerë trualli, ATP të kërkoje nga institucionet përkatëse ministria dërguese vlerësimin real të vlerës ndërtimore të objekteve të amortizuara,*

e. *Për 8 objekte, të cilat nga verifikimi pretendohen se nuk ekzistojnë si ndërtesa, me sipërfaqe totale trualli 83 581m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe nën objekte 21369 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 65 651m<sup>2</sup>, me vlerë të objekteve prej 457,879,444 lekë, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: 296,854,502 lekë vlera ndërtimore e objekteve dhe 161,024,941 lekë vlerë trualli, ATP marrë masa për të kërkuar nga institucionet përkatëse ministria dërguese vlerësimin real të vlerës ndërtimore të objekteve të amortizuara që nuk ekzistojnë,*

f. *Për 11 objekte, të zaptuara pa titull pronësie për të cilat nga verifikimi pretendohet se përdoren për aktivitet tregtar me sipërfaqe totale trualli 10214 m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe nën objekte 3626 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 6 588 m<sup>2</sup>, me vlerë të objekteve prej 117,938,672 lekë, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: 43,468,108 lekë vlera ndërtimore e objekteve dhe 74,470,564 lekë vlerë trualli, ATP të kërkojë pranë NJQV-ve verifikimin për dhënie leje ndërtimi të objekteve, në ZVRPP-të përkatëse identifikimin e gjendjes juridike të pasurive ndërtesa ekzistuese të zaptuara e përshtatura për aktivitete biznesi dhe gjendjes juridike të trojeve përkatës si dhe të kërkojë në rrugë ligjore në institucionet përkatëse ministria dërguese dhe ndaj personave zaptues, zhdëmtimin e dëmit në vlerën prej 43,468,108 lekë vlera ndërtimore e objekteve të zaptuara mbi të cilat është tjetërsuar me ndërtime.*

g. *Për 5 objekte, për të cilat nga verifikimi pretendohet se përdoren si zyra nga Institucione Shtetërore me sipërfaqe totale trualli 2517 m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe nën objekte 999 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 1 518 m<sup>2</sup>, me vlerë të objekteve prej 23,116,539 lekë, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: 17,236,739 lekë vlera ndërtimore e objekteve dhe 5,879,800 lekë vlerë trualli, ATP të kërkojë zyrtarisht e bëjë në dijeni institucionet zyrtare, NJQV-të që i posedojnë, ministrinë përkatëse të dërgimit me shkresë.*

h. *Për 1 objekt, për të cilin nga verifikimi pretendohet se është i hipotekuar, me sipërfaqe totale trualli 236 m<sup>2</sup> nga e cila sipërfaqe nën objekte 206 m<sup>2</sup>, sipërfaqe funksionale 30 m<sup>2</sup>, me vlerë të objekteve prej 6,830,591 lekë, sipas raporteve të vlerësimit nga e cila: 3,296,591lekë vlera ndërtimore e objekteve dhe 3,534,000 lekë vlerë trualli, ATP të identifikojë hipotekën, personin, në ZVRPP dhe ose të dërgojë dokumentin përkatës pranë ministrisë, dhe mbi këto fakte të kërkojë heqjen nga fondi i kompensimit fizik të këtij objekti si dhe të bëjë sistemimin dhe evidentimin e truallit nëse personi përfitues, posedues zotëron një Vendim nga AKKP, ATP; pasqyruar analitikisht në tabelat emërtuar “Objektet e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronarëve sipas viteve 2009-30.6.2016 me 7 flete”, “Tabela Përmbledhëse e Objekteve Për Kompensim Fizik sipas Viteve të Krijimit dhe Struktura 1 fletë”, “ Objektet(157) e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronave me Problematikat me 5 fletë“ “Objektet(97) e Fondit Fizik për Kompensimin e Pronave me Problematikat Grupuar me 3 fletë”;*

**Menjëherë**

**Gjetje 21:** Në ATP, ish AKKP Tiranë për periudhën prej v. 2009 deri 30.06.2016 janë depozituar kërkesa për tjetërsim të sipërfaqes oborr në përdorim dhe çelur 1431 dosje (1012 kërkesa deri 20 Tetor 2013 dhe 419 kërkesa pas 20 tetor 2013 deri 30.06.2016) dhe nuk janë trajtuar 1134 kërkesa-dosje, ose 79%, pasqyruar analitikisht në tabelën “Tabela e Kërkesave dhe Trajtimi për Oborret ne Përdorim”, ndërsa janë marrë 303 vendime për 303 dosje kërkesa ose (nga të cilat 297

nga ATP dhe 6 me vendime Gjykate) ose 21% pasqyruar analitikisht në tabelën **“Tabela Përmbledhëse e Vendimeve për Oborret v. 2014-2016”**, gjendje dhe mosveprime këto në kundërshtim me nenin, 23, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” të ndryshuar, nenit 24, 56, të ligjit 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 200, datë 19.02.2009 ‘Për Përcaktimin e Kushteve dhe për Procedurën e Tjetërsimit të Oborreve në Përdorim për Llogari të Fondit të Kompensimit Financiar”, i ndryshuar, të shkronjës (c) neni 25 ligji nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 578, datë 29.8.2012 “Për Përcaktimin e Procedurës së Kalimit në Pronësi të Oborreve në Përdorim”, i ndryshuar; që kanë sjellë si pasojë të ardhura të munguara potenciale deri në vlerën **431,257 mijë lekë** (për tu përdorur në fondin e kompensimit, të ardhura të pa merituar për shërbim të pakryer e transparencë të pamjaftueshme ndaj qytetarëve në vlerën prej **3,402 mijë lekë**, pasqyruar analitikisht në tabelën emërtuar **“Tabela Përmbledhëse të Ardhurat e Munguara dhe Dëme nga Vlera e Shitjes Oborreve dhe Tarifa e Shërbimit për Kërkesat e pa Trajtuara nga Sektori Oborreve Agjencia Trajtimit Pronave (ish-AKKP) 2009- 30/6/2016”**, trajtim selektiv të kërkesave pa ndjekur radhën, vonesa me disa muaj deri disa vite (kundrejt afatit ligjor 3 muaj) (*Trajtuar në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 21:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i oborreve të marrin masa për analizimin e performancës së pamjaftueshme, trajtimin selektiv të kërkesave për tjetërsim oborresh, nxjerrjen e përgjegjësisë ligjore zhdëmtuese si dhe të administrojnë inventarizojnë dokumentacionin përkatës lidhur me **1134 kërkesa-dosje**, ose 79%, të pa trajtuara prej mbi 6vjet tejkallim të afatit nga disa muaj deri disa vite, trajtuar pasqyruar analitikisht në tabelën **“Tabela e Kërkesave dhe Trajtimi për Oborret në Përdorim”**, që kanë sjellë si pasojë mungesë transparencë të ATP, të ardhura të munguara potenciale deri në vlerën **431,257 mijë lekë** (për tu përdorur në fondin e kompensimit, dhe të ardhura të pa merituar për shërbim të pakryer e transparencë të pamjaftueshme ndaj qytetarëve në vlerën prej **3,402 mijë lekë**, gjendje dhe mosveprime këto në kundërshtim me nenin, 23, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” të ndryshuar, nenit 24, 56, të ligjit 7843, datë 13.7.1994 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 200, datë 19.02.2009 ‘Për Përcaktimin e Kushteve dhe për Procedurën e Tjetërsimit të Oborreve në Përdorim për Llogari të Fondit të Kompensimit Financiar”, i ndryshuar, të shkronjës (c) neni 25 ligji nr. 33, datë 21.3.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, VKM nr. 578, datë 29.8.2012 “Për Përcaktimin e Procedurës së Kalimit në Pronësi të Oborreve në Përdorim”, i ndryshuar; pasqyruar analitikisht në tabelën emërtuar **“Tabela Përmbledhëse të Ardhurat e Munguara dhe Dëme nga Vlera e Shitjes Oborreve dhe Tarifa e Shërbimit për Kërkesat e pa Trajtuara nga Sektori Oborreve Agjencia Trajtimit Pronave (ish-AKKP) 2009-30/6/2016”**,

**Menjëherë**

**Rekomandim 22:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i oborreve të marrin masa për trajtim urgjent dhe vazhdimin e procedurave ligjore (dhe të njoftojë qytetarët kërkuar) të **1134 kërkesa-dosje**, ose 79%, të pa trajtuara prej mbi 6 vjet tejkallim të afatit nga disa muaj deri disa vite, trajtuar pasqyruar analitikisht në tabelën **“Tabela e Kërkesave dhe Trajtimi për Oborret në Përdorim”**, si dhe të analizojë sistemojë të ardhurat në vlerën prej **3,402 mijë lekë** të pa merituar për shërbim të pakryer e transparencë të pamjaftueshme ndaj qytetarëve.

**Deri shkurt 2017**

**Gjetje 22:** Nga ATP/AKKP Tiranë, nga punonjësit që kanë lëvizur nga vendi punës dhe që kanë ndërprerë punën, nuk është bërë me procesverbal marrja në dorëzim si dhe dorëzimi i dosjeve të kërkesave të oborreve nga përgjegjësit e sektorëve dhe nga specialistët përkatës prej viteve 2009 deri në momentin e auditimit, pasi nuk u paraqit asnjë dokument për këtë gjatë auditimit, veprime **në kundërshtim me legjislacionin për periudhën e mëparshme dhe me ligjin nr. 10296, datë**

**8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”,**

-në të gjitha rastet dosjet e audituara janë të pa inventarizuara me përbërjen e dokumentacionit përkatës; -në të gjitha raste nuk ka Aktverifikimi në terren, nuk ka Vlerësim Ligjor; veprime në kundërshtim me VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar sipas VKM nr. 790, datë 14.11.2012 pika 9.b.ç. ku përcaktohet: “Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit nga AKKP-ja kryhet sipas kësaj procedure.... b) Verifikimi i kushteve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, bëhet nëpërmjet inspektimit në terren nga punonjësit e AKKP-së”; ....ç) Në përfundim të shqyrtimit sipas afateve të mësipërme, AKKP-ja harton vlerësimin ligjor,.....”(Trajtuar në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 23:** ATP Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm dhe Sektori i oborreve të marrin masa të inventarizojnë me përbërjen e dokumentacionit përkatës të **1131 dosjet e oborreve**, ti administrojnë bëjnë hyrje në arkiv dhe dalja për përpunim e dorëzim kthim në arkiv të ndjekë rregullat e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe UM F nr. 30, datë 27.12.2011”Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”,

**Menjëherë dhe në Vazhdimësi**

**Gjetje 23:** ATP(ish AKKP) Tiranë ka marrë vendime për kompensim financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme, por në **3 raste** vendimet kanë gabim material në pikën 3 të tyre, ku shprehen për sipërfaqen e mbetur për kompensim të subjektit të shpronësuar, duke përcaktuar më tepër në total sipërfaqen prej **1014.5 m<sup>2</sup>**, e mbetur për kompensimin pasardhës, veprim në kundërshtim me pikën 7, të VKM-së nr. 889, datë 17.12.2014 “Për përcaktimin e rregullave dhe të kritereve për shpërndarjen e fondit të kompensimit të pronarëve, në të holla, për vitin 2014”(Trajtuar më hollësisht në faqe 74-75 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 24:** ATP (ish AKKP) Tiranë të marrë masa për të korrigjuar gabimin material në pikën 3, të vendimeve të ATP-së: nr. 79, datë 30.04.2015; nr. 156, datë 30.04.2015; nr. 103, datë 30.04.2015, si dhe në çdo rast tjetër vendimet e marra duhet të kenë saktësinë e duhur të përmbajtjes së tyre.

**Vazhdimësi**

**Gjetje 24:** ATP(ish AKKP) Tiranë nuk ka bashkëpunuar me ZVRPP, për të bërë të mundur ndarjen e kalimin në pronësi të shtetit, ose të përfituesit sipas lejes së legalizimit, të sipërfaqeve të kompensuar, pasi në **10 raste** janë marrë vendime për kompensimin e pronarëve që preken nga ndërtimet informale, për sipërfaqen në **total prej 5092 m<sup>2</sup>**, e cila rezulton në pronësi të përfituesve të kompensimit, edhe pasi është realizuar kompensimi i kësaj sipërfaqeje, veprim **në kundërshtim** me pikën 8 e 9, të VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për Përcaktimin e Procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 76-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 25:** ATP Tiranë të marrë masa, duke bashkëpunuar me ZVRPP-të, për të bërë të mundur ndarjen e kalimin në pronësi të shtetit, ose të përfituesit sipas lejes së legalizimit, për **10 raste** që janë marrë vendime për kompensimin e pronarëve që preken nga ndërtimet informale, për sipërfaqen **totale prej 5092 m<sup>2</sup>**, sipas tabelës nr. 3.

**Menjëherë**

**Gjetje 25:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **4 raste** ka marrë vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim” në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi **mungon dokumenti që vërteton ndërtimin e objektit para datës 10.08.1991**, veprim në kundërshtim me germën “b/ii” pika 5, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar (Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 26:** ATP Tiranë të marrë masa, që në vazhdimësi të plotësohet çdo dosje me dokumentacionin që vërteton vitin e ndërtimit të objektit, për të cilin kërkohet kalimi i pronësisë së oborrit, në të kundërt të ndërpritet procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për marrjen e vendimit për kalimin e pronësisë së oborrit.

#### Vazhdimësi

**Gjetje 26:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **2 raste** ka marrë vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim”, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi sipas konfirmimit të pushtetit vendor drejtuar ATP-së, këto sipërfaqe **janë përcaktuar sipas planeve rregulluese, për tu përdorur si hapësira publike**, veprim në kundërshtim me germën “c”, pika 5, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 27:** ATP Tiranë të marrë masa në bashkëpunim me pushtetin vendor, që të konfirmohet rast pas rasti gjendja e oborreve që pretendohet për tu kthyer dhe të saktësohet nëse janë përfshirë në listat e inventarit të pasurive, që i kanë kaluar pushtetit vendor, apo përfshirja e tyre në planet urbanistike për tu përdorur si hapësira publike, në të kundërt të ndërpritet procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për marrjen e vendimit për kalimin e pronësisë së oborrit.

#### Vazhdimësi

**Gjetje 27:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **4 raste** ka marrë vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim”, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi sipas konfirmimit të ZVRPP drejtuar ATP-së, **mbi truallin e tjetërsuar ka ndërtime të paligjshme**, për rrjedhojë ATP-ja nuk duhet të vazhdonte procedurën e shqyrtimit të kërkesës, veprim në kundërshtim me germën “ç”, pika 5, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 28:** ATP Tiranë të marrë masa duke bashkëpunuar me pushtetin vendor dhe institucione të tjera, që të konfirmohet rast pas rasti gjendja e oborreve që pretendohet për tu kthyer, në lidhje me zënien e tyre nga ndërtime informale dhe për çdo rast që rezulton me ekzistencën e tyre, të ndërpritet procedura e shqyrtimit të dokumentacionit, për marrjen e vendimit për kalimin e pronësisë së oborrit.

#### Vazhdimësi

**Gjetje 28:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **4 raste** ka marrë vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim”, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, pasi personi përfitues **nuk zotëron të gjithë objektin, por një pjesë të tij**, rrjedhimisht pronësia e oborrit në përdorim i takon në bashkëpronësi të gjithë prestarëve që zotërojnë pronësi në objekt, pasi shërben si sipërfaqe në funksion të gjithë objektit, sipas përcaktimeve në nenin 199, të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Për Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë”, për rrjedhojë ATP-ja nuk duhet të vazhdonte procedurën e shqyrtimit të kërkesës individuale, veprim në kundërshtim me germën “ç”, pika 3, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 29:** ATP Tiranë të marrë masa, që në vazhdimësi për çdo dosje gjendje dhe aplikimet në vijimësi, ku kërkohet kalimi i pronësisë së oborrit në përdorim, të saktësohet statusi juridik i objektit në lidhje me bashkëpronësinë dhe në çdo rast që rezulton se ka bashkëpronësi dhe është aplikuar në mënyrë individuale nga secili bashkëpronar, të procedohet me ndërprerjen e procedurës së shqyrtimit, për marrjen e vendimit përkatës për kalimin e pronësisë së oborrit. Procedura për marrjen e vendimit të vazhdohet vetëm në rastet, kur aplikimi është i përbashkët nga të gjithë bashkëpronarët që zotërojnë pjesë të objektit.

## Vazhdimësi

**Gjetje 29:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **asnjë rast** nuk ka respektuar afatet ligjore, në lidhje me shqyrtimin e dosjes nga data e aplikimit, deri në marrjen e vendimit përkatës, veprim **në kundërshtim** me pikën 12, të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar dhe me pikën 8 e 9, të VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për Përcaktimin e Procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 30:** ATP Tiranë të marrë masa, për të bërë të mundur shqyrtimin sa më parë, deri në marrjen e vendimit përkatës, për aplikimet që janë depozituar në dosjet përkatëse në ATP dhe shqyrtimin brenda afateve të atyre kërkesave, që do të depozitohen në të ardhmen.

## Vazhdimësi

**Gjetje 30:** ATP (ish AKKP) Tiranë, në **asnjë rast** nuk ka inventarizuar dosjet e çelura sipas kërkesave për shpërblim të sipërfaqes takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informate, veprim në kundërshtim me nenin 35 “Ruajtja e dokumentacionit”, të ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 31:** ATP Tiranë të marrë masa për të inventarizuar të gjithë dokumentet, të ndodhura në dosjet përkatëse, për të krijuar transparencë dhe siguri më të lartë të dokumenteve që dorëzohen nga qytetarët, për të marrë nga ATP shërbimet e kërkuara.

## Brenda datës 31.03.2017

**Gjetje 31:** Sipas faturës nr. 634, datë 29.12.2015, është likuiduar vlera 5,352,576 lekë për zërin “Data Entry”, për 16832 vendime, ndërkohë që fazë hedhja e vendimeve sipas Grafikut të Ekzekutimit është parashikuar të realizohet nga muaji i katërt deri në muajin e nëntë të kontratës. Likuidimi i faturës është shoqëruar vetëm me anë të një procesverbali me nr. 4351/14, datë 29.12.2015 për marrjen në dorëzim pa asnjë shënim a koment, nuk ka asnjë dokumentacion tjetër shoqërues, justifikues, si relacion, listë të vendimeve, apo DVD, ku të tregohet në mënyrë të detajuar vendimet që janë hedhur, **për pasojë likuidimi i kësaj faturë në vlerë 5,352,576 lekë është i pajustificuar dhe argumentuar në kundërshtim me** Ligjin Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve- pika 34, 35, germa b, 36, 52 dhe 54 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 32 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit i cili justifikon dhe argumenton likuidimin e urdhër shpenzimit si relacion, listë të vendimeve, apo DVD, ku të tregohet në mënyrë të detajuar vendimet që janë hedhur në sistem sipas viteve, në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës totale prej **5,352,576 lekë** nga operatori ekonomik [REDACTED]

**Gjetje 32:** ATP (ish AKKP) Tiranë nuk ka ushtruar dhe dokumentuar mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës për periudhën dhjetor 2015- qershor 2016, pasi nuk janë kryer kontrole periodike shoqëruar me dokumente justifikuese ndërsa ka pranuar likuidime të pa argumentuara. Kontrata duhet të përfundonte brenda datës 16.09.2016, kohë në të cilin Projekti duhet të ishte gati, të merrej në dorëzim dhe të përdorej nga punonjësit e Agjencisë së Trajtimit të Pronave si dhe të fillonte periudha e mirëmbajtjes e parashikuar në kontratë. Por jo vetëm që kontrata nuk ka përfunduar ende por nga Grupi për Koordinimin e Projektit dhe Mbikëqyrjen nuk disponohet informacion për ecurinë e procesit, vënien në punë të sistemit dhe afatet se kur do të përfundojë, duke vështirësuar ecurinë e

mëtejshme të këtij projekti me rëndësi të madhe për procesin 20 vjeçar të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe opinionin publik.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1 - Objekti dhe qëllimi, germa a) dhe b), VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 77- Mbikëqyrja Kontratës si dhe UKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 33:** ATP(ish AKKP) Tiranë, titullari i institucionit të marrë masa të menjëhershme për koordinimit me Bashkimin e Operatorëve Ekonomik fitues për mbikëqyrjen e kontratës dhe përfundimin e projektit me rëndësi të madhe për procesin 20 vjeçar të kthimit dhe kompensimit të pronave si dhe opinionin publik, në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në kontratë si dhe kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1 - Objekti dhe qëllimi, germa a) dhe b), VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 77- Mbikëqyrja Kontratës si dhe UKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

**Menjëherë**

**Gjetje 33:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në procedurën e prokurimit “Sistemi Web-Gis informacioni për regjistrimin dhe vlerësimin e pronave objekt kthimi dhe kompensimi AKPP-Web-Gis” viti 2015, në kushtet e veçanta të kontratës nr. 17/23 prot, datë 16.11.2015 nuk ka përcaktuar kushtet për periudhën 4 vjeçare të mirëmbajtjes, kontrollet periodike që do të kryhen, personat përkatës mbikëqyrës, çfarë do të përfshijë procesi i mirëmbajtjes, përgjegjësinë dhe detyrimet në rast të mos realizimi të mirëmbajtjes, mënyrën se si do të likuidohet ky shërbim (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 34:** ATP(ish AKKP) Tiranë, Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme duke bërë ndryshimet në kontratë si dhe të përcaktojë kushtet për periudhën 4 vjeçare të mirëmbajtjes, kontrollet periodike që do të kryhen, personat përkatës mbikëqyrës, çfarë do të përfshijë procesi i mirëmbajtjes, përgjegjësinë dhe detyrimet në rast të mos realizimi të mirëmbajtjes, mënyrën se si do të likuidohet ky shërbim.

**Menjëherë**

**Gjetje 34:** ATP (ish AKKP) Tiranë, në tre procedurat e prokurimit të zhvilluara në vitet 2014, 2015 dhe 2016 me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, përlllogaritja e fondit limit nuk është e argumentuar, pasi mungojnë procesverbalet apo akt verifikimet si dhe ofertat e marra nga operatorët ekonomik për studimin e tregut për shpenzimet uniforme dhe administrative në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 59- Llogaritja e Vlerës Kontratës (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 35:** ATP (ish AKKP) Tiranë, Njësia e Prokurimit të marrë masa që në çdo rast për procedurat e prokurimit të bëhet argumentimi i fondit limit shoqëruar me dokumente justifikuese, si dhe studimin e tregut në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 59- Llogaritja e Vlerës Kontratës.

**Në vazhdimësi**

**Gjetje 35:** ATP(ish AKKP) Tiranë, për periudhën e auditimit 01.01.2014-30.06.2016 ka zhvilluar 5 procedura negociim pa shpallja me objekt “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” duke përfshirë këtu dhe dy shtesat e kontratave përkatësisht

për vitet 2015 dhe 2016, ku në 3 prej tyre është shpallur fitues operatori ekonomik “O” Sh.p.k, gjithashtu dhe për vitet 2014 dhe 2015 në procedurat normale të prokurimit “Kërkesë me Propozim” është shpallur përsëri fitues operatori ekonomik “O” Sh.p.k, pra i njëjti operator ekonomik. Shmangia e procedurave normale të prokurimit ka kufizuar konkurrencën e lirë dhe favorizon operatorë të caktuar ekonomik në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Neni 1 - Objekti dhe qëllimi dhe Neni 46-Kualifikimi i ofertuesve, pika 3 (Trajtuar më hollësisht në faqe 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 36 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, Njësia e Prokurimit të marrë masa për të shmangur vonesat në procedurat e prokurimit, përcaktimi i kritereve të kualifikimit të sakta dhe jo diskriminuese, shmangien e përdorimit të procedurave me negociim pa shpallje duke përdorur procedurat normale të prokurimit në përputhje me parimet e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, si dhe kërkesat e VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke stimuluar konkurrencën e lirë dhe jo favorizimin e operatorëve të caktuar.

### Në vazhdimësi

**Gjetje 36:** ATP(ish AKKP) Tiranë, për vitin 2014 nuk ka ngritur Komisionin për marrjen në dorëzim të shërbimeve, mungon urdhri i titullarit të Autoritetit Kontraktor. Procesverbalet e mbajtura për marrjen dhe dorëzimin e detyrës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike nuk janë të rregullta për gjatë gjithë periudhës së shërbimit. Nga ana e Autoritetit Kontraktor nuk është mbajtur dokumentacion për kontrollet e kryera për zbatimin e kontratës. Mungojnë procesverbalet ditore të shërbimit për marrjen dhe dorëzimin e detyrës si dhe kontrollet e kryera për periudhën nga 01.01.2014-deri në datë 30.07.2014. Urdhër shpenzimet e administruara nga Sektori i financës shoqërohen vetëm nga kontrata e lidhur, fatura tatimore e TVSH e nënshkruar nga Përgjegjësjja e Sektorit të Burimeve Njerëzore zj. E C dhe asnjë dokumentacion tjetër shoqërues e justifikues në lidhje me kontrollet për zbatimin e kontratës. Vlerat e likuiduara prej **1,203,818 lekë me TVSH** përkatësisht për faturat nr. 12, datë 31.01.2014, nr. 35, datë 28.02.2014, nr. 73, datë 31.06.2014, nr. 87, datë 23.04.2014, nr. 1892, datë 30.04.2014, nr. 1948, datë 29.05.2014, nr. 2006, datë 30.06.2014, nr. 2069, datë 31.07.2014, trajtuar sipas tabelës nr. 1. “*Likuidimet viti 2014*”, dhe vlera **333,032 lekë me TVSH** sipas faturave tatimore nr. 268, datë 31.05.2016 dhe nr. 291, datë 10.06.2016, trajtuar sipas tabelës tabela nr. 3 “*Likuidimet viti 2016*” janë të pajustificuara.

Veprimet më sipër bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 77 Mbikëqyrja e kontratës, Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes se aktiveve- pika 34, 35, germa b, pikat 36, 52 dhe 54, pasi urdhër shpenzimet nuk janë shoqëruar me procesverbalet për dorëzimin dhe marrjen e detyrës, si dhe relacionet e Grupit të Marrjes në Dorëzim të Detyrës (Trajtuar më hollësisht në faqe 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 37 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit i cili justifikon dhe argumenton likuidimin e urdhër shpenzimeve përkatëse, në rast të mosplotësimit të dokumentacionit të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës totale prej 1,536,850 lekë nga operatori ekonomik “O” Sh.p.k dhe “TS” Sh.p.k.

### Menjëherë

**Rekomandim 38 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, Sektori i Financës të marrë masa që të gjitha likuidimet dhe konkretisht për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë, të kryhen në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes se aktiveve- pika 34, 35, germa b, pikat 36, 52 dhe 54, duke i shoqëruar me dokumentacion

justifikues, si procesverbale dorëzimi dhe marrjes të detyrës, procesverbale, akt-kontrolle periodike ose relacion përmbledhës mujor për zbatimin e kontratës në përputhje me specifikimet e kontratës.

**Gjetje 37:** Në një rast gjatë zbatimit të kontratës për shërbimin e rojeve dhe sigurisë për vitin 2014 në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, likuidimi i vlerës prej 318,289 lekë me TVSH, mbi vlerën prej 1,557,144 lekë me TVSH për të cilën është lidhur kontrata bazë, si dhe vlerës 202,419 lekë me TVSH për shtesën e kontratës, pa amenduar më parë kontratën bazë në përputhje me ndryshimet ligjore si dhe i pa shoqëruar me dokumentacionin për likuidimin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore llogaritur sipas nivelit të ri të pagës bazë të dorëzuara nga operatori ekonomik, vjen në kundërshtim me përcaktimet e kontratës nr. 29, datë 09.04.2014, neni 14- Çmimi i kontratës, Neni 17- Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve, pika 17.1, si dhe ligjin nr. 10296, datë “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe UKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve- pika 34, Pika 35, *germa b. Dokumente vërtetues*, Pika 36, 52, 54 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 39:** ATP(ish AKKP) Tiranë të marrë masa që në çdo rast të ndryshimit të kushteve të kontratës të bëhet më parë amendimi i saj në përputhje me përcaktimet e kontratës si dhe kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Gjithashtu Sektori i Financës të marrë masa që në çdo rast likuidimi i urdhër shpenzimeve të shoqërohet me dokumentacion justifikues sipas kërkesave të ligjin nr. 10296, datë “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe UKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve- pika 34, Pika 35, *germa “b”- Dokumente vërtetues*, Pika 36, 52, 54.

#### Në vazhdimësi

**Gjetje 38:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël gjatë vitit 2014 faturat tatimore nuk janë firmosur nga i gjithë grupi i marrjes në dorëzim sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç” ku citohet se “Në çdo rast, faturat e mallrave apo të shërbimeve duhet të jenë të rregullta e sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të nënshkruhen nga anëtarët e komisionit. Faturat e lëshuara kanë vlerën e kontratës së lidhur” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 40 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, Njësia e Prokurimit të marrë masa për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, faturat tatimore të firmosen nga grupi i marrjes në dorëzim sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VI, pika 2, shkronja “ç” dhe UKM nr. 30, datë “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

#### Në vazhdimësi

**Gjetje 39:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në 5 raste në procedurat e prokurimit me vlera të vogla për vitet 2014, 2015 dhe 6 mujori i parë 2016 mungon relacioni apo procesverbali konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Burimeve Njerëzore, për dëmtimet e ndodhura apo nevojën për mallra, punë dhe shërbime, gjithashtu në dy raste shërbimet dhe mallrat e prokuruar janë të njëjta me ato të një viti më parë pa dhënë shpjegime bindëse për nevojën e realizimit të tyre. Mungesa e relacionit apo procesverbalit konstatues nga personat kompetent, për dëmtimet e ndodhura apo nevojën për mallra, punë dhe shërbime bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013, “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë” ndryshuar, ku është përcaktuar se: “Kërkuesi i shërbimit bën kërkesë për prokurime me vlerë të vogël brenda limitit të përcaktuar nga ligji së bashku me specifikimet teknike, kriteret për përzgjedhjen e fituesit,

*afatin kohor për dorëzimin e propozimeve dhe kushtet kryesore të kontratës” (Trajtuar më hollësisht në faqe 56- 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Rekomandim 41:** ATP (ish AKKP) Tiranë, Njësia e Prokurimit të marrë masa për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të shoqërohen me relacion apo procesverbal konstatues nga personat kompetent dhe nga Sektori i Burimeve Njerëzore, për dëmtimet e ndodhura apo nevojën për mallra, punë dhe shërbime në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Neni 40-Prokurim me vlerë të vogël, pika 3, dhe UMF, nr. 33, datë 11.07.2013.

**Në vazhdimësi**

**Gjetje 40:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në 6 raste në procedurat e prokurimit me vlera të vogla gjatë vitit 2014 mungon relacioni për argumentimin dhe miratimin e fondit limit si dhe procesverbali për testimin e tregut, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, kreut II, pika 2- Llogaritja e vlerës së kontratës, shkronja “c” dhe “ç” (Trajtuar më hollësisht në faqe 56- 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 42:** ATP (ish AKKP) Tiranë, Njësia e Prokurimit të marrë masa për çdo rast në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, të shoqërohen me relacion apo procesverbal për argumentimin dhe miratimin e fondit limit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 59- Llogaritja e Vlerës Kontratës.

**Në vazhdimësi**

**Gjetje 41 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, në pjesën më të madhe të procedurave të prokurimit me vlera të vogla për vitet 2014, 2015 dhe 6 mujori i parë 2016, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallit, faturat tatimore apo fletë hyrjet nuk përmbajnë detajimin sipas artikujve dhe specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, por vetëm është shënuar sasia totale e mallit dhe vlera përkatëse, kurse në dy raste ka mos përputhje ndërmjet procesverbalit të marrjes në dorëzim dhe faturës tatimore si dhe fletë hyrjes, veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 45, 47, 52 dhe 54 (Trajtuar më hollësisht në faqe 56- 64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 43:** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa që për çdo rast në procedurave të prokurimit me vlera të vogla, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve të detajohen sipas artikujve dhe specifikimet teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë dhe dokumentet e tenderit në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 23 “Specifikimet teknike” dhe nenin 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu IX, Neni 77, Mbikëqyrja e kontratës”, pika 1, 2, 3 dhe 4, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 42, 43, 45, 47, 52 dhe 54.

**Në vazhdimësi**

**Gjetje 42:** ATP (ish AKKP) Tiranë, Sektori i tjetërsimit të Oborreve ka nxjerrë vendimin nr. 397, datë 20.07.2015, nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm për kthim me kundërshtëpërbllim të oborrit me sipërfaqe 162 m<sup>2</sup>, për subjektin B Ç në kundërshtim me VKM nr. 578, datë 29.8.2012 të Këshillit të Ministrave, ndryshuar, pika 9, germa c dhe ç, pasi në total sipërfaqja e pasurive me nr. 1/302, sip. 50 m<sup>2</sup>, nr. 1/373, sip. 70 m<sup>2</sup>, si dhe duke llogaritur pjesën e trotuarit prej 0.8 m<sup>2</sup> pra 27.4 m<sup>2</sup>, bën **147.4 m<sup>2</sup> në total dhe jo 162 m<sup>2</sup>**, për pasojë sipërfaqja prej **14.6 m<sup>2</sup>**, nuk duhet të

tjetërsohej, pasi është pjesë e pasurisë shtet nr. 1/304, e cila sipas shkresës nr. 9199/1, datë 18.10.2012 të Bashkisë Tiranë, bën pjesë në inventarit e pronave të Bashkisë Tiranë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 114-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 44:** ATP (ish AKKP) Tiranë, të marrë masa dhe t'i kërkojë ZVRPP Tiranë kufizimin e pasurisë përfituar nga subjekti B Ç deri në saktësimin e dokumentit të pronësisë si dhe kthimin e sipërfaqes tepër prej 14.6 m<sup>2</sup> pjesë e pasurisë shtet nr. 1/304, zk. 8180 të përfituar padrejtësisht.

**Menjëherë**

**Gjetje 43:** Në ATP(ish AKKP) Tiranë, për periudhën 2013-6 mujori i parë 2016 mungon informacioni i plotë dhe bilanci në lidhje me numrin e vendime gjyqësore, kërkesë padive, procesin e ankimimit si dhe me ecurinë e tyre, çka do të bënte të mundur dhënien e një opinionit të saktë për ndjekjen e procedurave të ankimimit nga Specialistët përkatës si dhe efektet e tyre në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave. Mangësitë në administrimin e dokumentacionit si dhe mos mbajtja e procesverbalit për marrjen dhe dorëzim e detyrës vinë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 221, datë 23.03.2016 “Për mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të ATP”, pika 13, si dhe nenin 13 të Rregullores “Për Organizimin e punës në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 4793, datë 02.07.2008 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 45 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, Titullari i Institucionit, Sektori i Përfaqësimit Ligjor të marrë masa për krijimin e një data-base apo regjistri elektronik për kërkesë padit dhe vendimet gjyqësore sipas një formati IT të shkallëzuar sipas fazave të proceseve gjyqësore, raportimet tek Përgjegjësi i Sektorit, e cila do t'i shërbejë punës në vazhdimësi të institucionit, krijimit të një baze të dhënash institucionale statistikore si dhe procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave.

**Menjëherë**

**Rekomandim 46:** ATP (ish AKKP) Tiranë, Titullari i Institucionit të marrë masa që në çdo rast të marrjes dhe dorëzimit të detyrës nga punonjësit të mbahet procesverbal në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30, datë 27/12/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 13.

**Në vazhdimësi**

**Gjetje 44:** ATP(ish AKKP) Tiranë, Sektori i Përfaqësimit Ligjor ka pasur një organike të reduktuar përsa i përket inspektorëve në raport me çështjet në ngarkim për ndjekje në zbatim të Ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar duke u fokusuar më tepër rreth çështjeve të ngritura në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Me hyrjen në fuqi të ligjit 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” si pasojë e vendimeve që do të merren nga ATP pritet të shtohet një fluks i madh çështjesh të cilat do të jenë objekt shqyrtimi nga gjykatat, si për rastet e njohjes së të drejtës së pronësisë ashtu edhe për ekzekutimin e të drejtës së kompensimit të pronës (*Trajtuar më hollësisht në faqe 140-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 47:** ATP(ish AKKP) Tiranë, Titullari i Institucionit të marrë masa të menjëhershme për plotësimin e strukturës të Sektorit i Përfaqësimit Ligjor në përputhje me Urdhrin nr. 87, datë 17.05.2016 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”, me qëllim përbalimin e fluksit të proceseve gjyqësore duke bërë një shpërndarje sa më të mirë jo vetëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë por duke e shtrirë përfaqësimin në të gjitha Gjykatat e Rretheve Gjyqësore, me qëllim zvogëlimin e efekteve negative dhe financiare për procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave.

**Menjëherë**

**Gjetje 45:** Nga auditimi me zgjedhje i 120 dosjeve, mbi vlerësimin, pranimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kompensim për pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale u konstatua vetëm në një rast është njoftuar subjekti kërkues e përfitues në lidhje me lëvrimin e kështit të kompensimit, veprime në kundërshtim me VKM nr. 383, datë 19.05.2010 me ndryshime.

- në 35 raste nuk janë respektuar afatet ligjore të përcaktuar pasi ka kaluar afati ligjor i shqyrtimit të kërkesës prej 3 muaj përcaktuar në VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale” me ndryshime pikat 8 dhe 9 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 114-121, 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 48:** ATP Tiranë të marrë masatë që në kuadër të transparencës dhe sigurisë më të lartë që qytetarët të marrin nga ATP shërbimet e përcaktuara në ligj, për çdo rast shqyrtimi të dosjeve të kërkesave të zbatohen afatet e përcaktuara dhe për çdo rast në çelëj të fondi kompensimi të informohen zyrtarisht përfituesit.

#### Në vijimësi

**Gjetje 46:** Nga auditimi me zgjedhje i 50 dosjeve të kërkesave për shpërblim të sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale në asnjë rast nuk kanë inventar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” neni 35 “Ruajtja e dokumentacionit” ku përcaktohet: - *“Dokumentacioni i procesit të njohjes e kompensimit të pronave ruhet, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.....”* si dhe në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 49:** ATP Tiranë të marrë masa, që të dokumentojë gjithë lëvizjen e dokumentacionit si dhe për të inventarizuar të gjithë dokumentet e administruar në dosjet e kërkesave për shpërblim të sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, për të krijuar transparencë dhe siguri më të lartë në shërbimin ndaj qytetarëve.

#### Në vijimësi

**Gjetje 47:** Nga auditimi me zgjedhje i 50 dosjeve, bazuar në konfirmimin zyrtar të ardhur nga ZVRPP, në 13 raste ku ish pronarët e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimet informale janë kompensuar financiarisht për sipërfaqe prej 8,334 m<sup>2</sup> në vlerë **55,737,525 lekë**. Pasuritë e kompensuar nuk kanë ndryshuar statusin juridik të tyre për të kaluar me pronar shtet apo për tu regjistruara sipas lejes së legalizimit, veprim në kundërshtim me VKM nr. 383, datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale” me ndryshime pikat 7 dhe 8 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 50:** ATP Tiranë të marrë masa, që në bashkëpunim zyrtar me ZVRPP-të, të saktësohen statutet ligjore në lidhje me ndryshimin e titullit të pronësisë nga përfituesit e kompensimit financiar në vlerë 55,735,525 lekë, dhe kalimin në pronar shtet apo në pronar privat që ka përfituar leje legalizimi, për sipërfaqen e kompensuar në **total prej 8,334 m<sup>2</sup>, për 13 raste** të pasqyruara në tabelën.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 48:** Agjencia e Trajtimit të Pronës nuk ka planifikim apo kritere të përcaktuara në analizimin e dosjeve të kërkesave për kalimin në pronësi të sipërfaqeve “oborr në përdorim”, nuk janë të përcaktuara koha e plotësimit me dokumentacionin ligjor, mënyra e shqyrtimit, kushtet apo dhe koha shqyrtimit të kërkesave nga depozitimi i kërkesave për kalimin në pronësi të sipërfaqeve “oborr

në përdorim”, si dhe nuk ka një metodikë për kontrollin apo konfirmimin e regjistrimit të këtyre pasurive në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme. Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2016 deri në 30.06.2016 nga totali i kërkesave të pa shqyrtuara prej 1191 dosjesh, janë marrë në shqyrtim dhe kanë dalë me Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm vetëm 60 dosje. Vendimeve të marra në vitin 2016 sipas viteve të depozitimit të kërkesave i përkasin; 5 kërkesa të depozituara në vitin 2016, 15 kërkesa të depozituara në vitin 2015, 4 kërkesa të depozituara në vitin 2014, 10 kërkesa të depozituara në vitin 2013, kërkesa të depozituara në vitin 2012, 7 kërkesa të depozituara në vitin 2011, 6 kërkesa të depozituara në vitin 2010 dhe 2 kërkesa të depozituara në vitin 2009 (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 51:** Agjencia e Trajtimit të Pronës të marrë masa që dosjet/kërkesat për tjetërsimin e oborreve në përdorim, të plotësohen me dokumentacionin e kërkuar ligjor, të përpunohen sipas një programi të detajuar iniciuar sipas kohës së depozitimit të tyre, duke konkluduar me daljen e Vendimit për tjetërsim/refuzim, kjo edhe në përputhje e zbatimit të planit të veprimit të miratuar me VKM nr. 236, datë 23.04.2016, për zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronave në Shqipëri.

**Në vijimësi**

**Gjetje 49:** Përgjigjet e Njësive të Qeverisjes Vendore në të shumtat e rasteve janë evazive në formulimin – “Në zbatim të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001, për “Pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitëe qeverisjes vendore”, VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, Bashkia e Tiranës vazhdon ende procesin e inventarizimit të pronave të saj dhe një informacion me i plotë do të jetë i mundur pas përfundimit të këtij procesi”. Nuk ka listë pronash bashkëlidhur përgjigjes zyrtare cka bie në kundërshtim me ligjin nr 8744, datë 22.02.2001 i ndryshuar dhe VKM nr. 500, datë 18.04.2001 i ndryshuar si dhe me VKM nr. 578, datë 29.8.2012 Pika 5. Ku përcaktohet – “AKKP-ja ngarkohet të kryejë procedurën paraprake për tjetërsimin, në pronësi të poseduesve të oborreve në përdorim, që plotësojnë kushtet e përcaktuara, si më poshtë vijon: c)Të jenë në pronësi të shtetit, ndonëse të paregjistruara si të tilla, por të pa transferuara në inventarin e pronave të organeve të qeverisjes vendore, në përputhje me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar”.

-Nga ATP për 60 Vendime të mara në vitin 2016 për kalimin në pronësi të sipërfaqeve “oborr në përdorim”, në kundërshtim me pikën 5 të VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, në 9 raste megjithëse nga NJ.Q.V. ka konfirmim që pasuritë e kthyera (oborr në përdorim) janë në listën e pronave të tyre por të pa inventarizuara është vepruar me kalimin e pronësisë të sipërfaqes “oborr në përdorim” (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 52:** Agjencia e Trajtimit të Pronës në marrjen e Vendimeve për tjetërsimin e oborreve në përdorim, në asnjë rast të mos konkludojë, kur përgjigjet nga NJ.Q.V nuk shoqërohet me listën e pronave në inventar të NJ.Q.V. apo në proces transferimi në pronësi.

Për 9 rastet të Vendimeve për tjetërsim me/pa kundër shpërblim të kërkohej nga NJ.Q.V. konfirmim zyrtar të nominuar për ndodhet në listë e pronave për transferim dhe statusi juridik aktual. Në rastet e përgjigjeve të ndodhjes në listën, pronë të NJ.Q.V.-së të procedohet me anulim Vendimi. Konkretisht me Vendimet e ATP si më poshtë

Vendimi nga ATP nr. 66, datë 10.06.2016, të një sipërfaqeje 95 m<sup>2</sup>. Tiranë

Vendimi nga ATP nr. 3, datë 16.02.2016, të një sipërfaqeje 277 m<sup>2</sup>. Tiranë

Vendimi nga ATP nr. 6, datë 16.02.2016, të një sipërfaqeje 91.2 m<sup>2</sup>. Tiranë

Vendimi nga ATP nr. 69, datë 23.06.2016, të një sipërfaqeje 280 m<sup>2</sup>. ZK 8140 Tiranë

Vendimi nga ATP nr. 72, datë 28.06.2016, të një sipërfaqeje 187 m<sup>2</sup>. ZK 8370 Tiranë.

Vendimi nga ATP e nr. 61, datë 09.06.2016, të një sipërfaqeje 200 m<sup>2</sup>. ZK 8310 Tiranë.

Vendimi nga ATP nr. 26, datë 22.04.2016, të një sipërfaqeje 258.6 m<sup>2</sup>. ZK 8603 Vlorë.  
Vendimi nga ATP nr. 27, datë 22.04.2016, të një sipërfaqeje 258.6 m<sup>2</sup>. ZK 8603 Vlorë.  
Vendimi nga ATP nr. 28, datë 27.04.2016, të një sipërfaqeje 500 m<sup>2</sup>. ZK 8310 Tiranë.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 50:** Dosjet e kërkesave për tjetërsimin e sipërfaqeve “Oborr në përdorim” në asnjë rast nuk kanë inventar, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” neni 35 “Ruajtja e dokumentacionit” ku përcaktohet: - *“Dokumentacioni i procesit të njohjes e kompensimit të pronave ruhet, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.....”* si dhe ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “PËR ARKIVAT” (Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 53:** ATP Tiranë të marrë masa, që të dokumentojë gjithë lëvizjen e dokumentacionit si dhe për të inventarizuar të gjithë dokumentet e administruar në dosjet e kërkesave për tjetërsimin e sipërfaqeve “Oborr në përdorim”, për të krijuar transparencë dhe siguri më të lartë në shërbimin ndaj qytetarëve

**Në vijimësi**

**Gjetje 51:** Nga ATP në 2 raste është marrë vendim për kalimin në pronësi të sipërfaqes “oborr në përdorim” edhe pse ka parregullsi në dokumentacion. Në konfirmimin mbi statusin dhe ndarjen e pasurisë nga ZVRPP Tiranë, Harta Treguese e Regjistrimit për pasurinë përmban adresë të ndryshme me kërkuesin referuar kjo dokumentacionit administruar në dosjen e kërkesës (Trajtuar më hollësisht në faqe 83-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 54:** Agjencia e Trajtimit të Pronës për dy rastet me parregullsi në dokumentacion (përshkrimi i ndryshëm i adresës së pasurisë) përkatësisht në Vendimin me nr. 58, datë 09.06.2016, për tjetërsim me kundër shpërblim të një sipërfaqeje 218 m<sup>2</sup> dhe Vendimin me nr. 59, datë 09.06.2016, për tjetërsim me kundër shpërblim të një sipërfaqeje 342.8 m<sup>2</sup>. Të kërkojë zyrtarisht nga ZVRPP konfirmimin e adresave në Hartat Treguese të Regjistrimit për pasurinë me nr. 5/196, regjistruar Volumi 24, faqe 233, ZK 8360 Tiranë.

**Deri në datë 28.02.2016**

**Gjetje 52:** ATP nga 60 Vendime të mara në vitin 2016 për kalimin në pronësi të sipërfaqeve “oborr në përdorim”. Në 6 raste në sipërfaqet e tjetërsuara (oborr në përdorim) sipas dokumentacionit të administruar në dosje ka të evidentuara ndërtime pa leje. Veprim në kundërshtim me VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, pika 5. ç) ku përcaktohen *“Këto sipërfaqe toke duhet të rezultojnë fizikisht të lira dhe të pazëna nga ndërtime pa leje, sipas kuadrit ligjor përkatës.”* (Trajtuar më hollësisht në faqe 83-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 55:** ATP Tiranë të marrë masa, në bashkëpunim zyrtar me ZVRPP-të, dhe Agjencinë Rajonale të ALUIZNI-t , për të saktësuar statusin ligjorë në lidhje me ndërtimet pa leje ne sipërfaqet “oborr në përdorim” të tjetërsuar sipas Vendimeve;

Vendimi nga ATP është me nr. 59, datë 09.06.2016

Vendimi nga ATP është me nr. 58, datë 09.06.2016

Vendimi nga ATP është me nr. 4, datë 16.02.2016

Vendimi nga ATP është me nr. 7, datë 16.02.2016

Vendimi nga ATP është me nr. 61, datë 09.06.2016

Vendimi nga ATP është me nr. 28, datë 27.04.2016

Në rastet e përgjigjeve zyrtare nga ALUIZNI dhe ZVRPP të konfirmimit të ndërtimeve pa leje në pasuritë e tjetërsuara si “oborr në përdorim” të trajtuara nga ALUIZNI, të procedohet me anulim Vendimi.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 53:** Për periudhën objekt auditimi 01.01.2014 deri në 30.06.2016 nga ATP (ish-AKKP) nuk ka vendime për kthim prone dhe për kompensim në natyrë apo vlerë të pronave, pra rezulton se është pezulluar kompensimi fizik dhe në vlerë të pronës, nuk është realizuar asnjë proces kompensimi fizik dhe në vlerë për llojin e pronës truall, tokë bujqësore, pyje, livadhe apo kullota, pezullim i cili nuk mbështetet me aktet ligjore si;

-ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”; neni 1 pika b, neni 28; - ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”; neni 1 pika “b”, neni 12; -VKM Nr. 1077, dt. 18.6.2008 “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullor”, me VKM e mësipërme në fondin e ATP (AKKP) ka kaluar pyje e kullota me një sipërfaqe prej 50,989.76 ha, i vlerësuar financiarisht me rreth 60 miliardë lekë. Në momentin e auditimit nga ATP nuk është vlerësuar financiarisht ky fond, nuk ka një metodikë apo akt ligjor ku është mbështetur vlerësimi financiar i fondit pyjor e kullor; -VKM nr. 222, datë 23.03.2016 “Për trajtimin e kërkesave për njohje të pronës e të kompensimit të saj”; -VKM nr. 223, datë 23.3.2016 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për vlerësimin dhe shpërndarjen e fondit financiar e fizik për kompensimin e pronave”; -VKM nr. 770, datë 12.11.2014 “Për kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23,368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim njësite të qeverisjes vendore” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 138-139 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 56:** Agjencia e Trajtitimit të Pronës Tiranë të marrë masa që në kuadrin e legjislacionit në fuqi, të përfundojë vlerësimin financiar të fondit pyjor dhe kullor me një sipërfaqe prej 50,989.76 ha që ka kaluar në fondin fizik të ATP-së me VKM nr. 1077, datë 18.06.2008, si dhe vazhdimin e procesit vendimmarrës për kompensim fizik e në vlerë për llojin e pronës truall, tokë bujqësore, pyje, livadhe apo kullota.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 54:** Likuidimi faturës tatimore nr. 542, datë 23.11.2015 në vlerën prej 16,800,000 lekë me TVSH, për Fazën përgatitore të Projektit dixhitalizimit Web-Gis, një javë pas lidhjes së kontratës, vetëm me anë të një Raporti Fillestar prej 22 faqesh, ku një pjesë e tij janë përshkrime të njëjta me ato që janë bërë në dokumentet standarde të tenderit, **pa asnjë dokumentacion tjetër shoqërues e verifikues me tregues të matshëm fizik, kosto çmim dhe argumentim të vlerës së likuiduar, është i pajustificuar dhe i paargumentuar veprime këto që bien në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes se aktiveve- pika 34, 35, germa b, 36, 52 dhe 54 (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).**

**Rekomandim 57 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa të kërkojë nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C P & G C”, dorëzimin e dokumentacionit justifikues e ligjorë që argumenton likuidimin e vlerës **16,800,000 lekë**, në rast të kundërt të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës totale si shpenzim i paargumentuar me dokumentacion dhe jo në përputhje përcaktimet e bëra në Dokumentet Standarde të Tenderit dhe Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Dokumentimi i lëvizjes se aktiveve- pika 34, 35, germa b, 36, 52 dhe 54

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **125,854,404 lekë**, si më poshtë:

**Gjetje 1:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në **20 raste** ka marrë vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim” në mospërputhje me përcaktimet ligjore, lidhur me kalimin në pronësi të poseduesit, të sipërfaqes takuese të truallit nën objekt dhe “oborr në përdorim”, duke **tjetërsuar më tepër truallin me sipërfaqe totale 4691.1 m<sup>2</sup>, nga pronësia shtet tek subjektet private**, për rrjedhojë ka krijuar **dëm ekonomik dhe të ardhura të munguara** në buxhetin e shtetit dhe buxhetin e ATP-së, në vlerën **74,388,975 lekë**, veprim në kundërshtim me germën “c”, pika 9(përcaktimet e sipërfaqeve sipas Aneksit 1), të VKM nr. 578, datë 29.08.2012 “Për Përcaktimin e procedurës së kalimit në pronësi të oborreve në përdorim”, i ndryshuar, me nenin 4, të VKM nr. 185/1956 dhe nenin 1, të VKM-së nr. 11/1957, me nenin 31, të VKM-së nr. 282/1961 dhe me nenin 1, të dekretit 4824/1971, me nenin 10, të dekretit 5747/1978 dhe me nenin 6, të dekretit 7011/1985 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 95-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 1:** Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **74,388,975 lekë**, që i përket **20 rasteve të tjetërsimit më tepër të truallit me sipërfaqe totale 4691.1 m<sup>2</sup>**, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar padrejtësisht nga personat përkatës, sipas tabelës bashkëlidhur, dhe konkretisht si më poshtë:

- A M **shumën 2,805,000 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 330 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 3, datë 19.01.2015.
- M M **shumën 740,324 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 299 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër, sipas Vendimit të ATP-së nr. 9, datë 28.01.2015, ndryshuar me Vendimin nr. 34, datë 18.03.2015.
- A H **shumën 8,384,425 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 12, datë 19.02.2015.
- S M **shumën 2,307,400 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 278 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 14, datë 19.02.2015.
- L O **shumën 5,509,650 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 230 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 36, datë 18.03.2015.
- R A **shumën 4,368,100 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 220 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 41, datë 23.03.2015.
- L K **shumën 4,145,177,00 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 231.6 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 4, datë 22.01.2015.
- J B **shumën 5,369,400 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 25, datë 04.03.2015.
- V D **shumën 3,529,028 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 92 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 45, datë 27.03.2015.
- I Ç **shumën 876,148 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 83 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 56, datë 07.04.2015.
- Xh Z **shumën 8,000,970 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 334 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër, sipas Vendimit të ATP-së nr. 65, datë 09.04.2015.
- Sh M **shumën 5,369,400 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 72, datë 30.04.2015.

- M K **shumën 3,694,600 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 367, datë 30.04.2015.
- B O **shumën 916,750 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 368, datë 30.04.2015.
- K P **shumën 5,936,645 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 299 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 380, datë 18.06.2015.
- Sh P **shumën 3,166,800 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 381, datë 25.06.2015.
- D B, A B, I B dhe L B **shumën 9,269,158 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 444.5 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimeve të ATP-së: nr. 57, datë 8.04.2015; nr. 58, datë 8.04.2015; nr. 59, datë 8.04.2015; nr. 60, datë 8.04.2015.

**Brenda datës 30.04.2017**

**Gjetje 2:** ATP(ish AKKP) Tiranë, Sektori i Tjetërsimit të Oborreve në **7 raste** ka tjetërsuar **1612.2 m<sup>2</sup>** sipërfaqe shtet mbi normën e përcaktuar sipas Aneksit nr. 1 të VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, për të cilat duhet të aplikohet çmimi për vlerën e truallit sipas zonave kadastrale në mbështetje të VKM 514, datë 30.07.2014 “Për miratimin e vlerës së pronës për secilin qark të Republikës së Shqipërisë”, **për pasojë detyrimi i munguar dhe dëmi ekonomik llogaritet në vlerën 22,458,705 lekë**. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 578 datë 29.08.2012 i ndryshuar, pika 7, pika 8, germa “ç”, pika 9, germa “b”, dhe sipas periudhave Ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin e kompensimin e pronës” i ndryshuar dhe Ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (Trajtuar më hollësisht në faqe 114-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 2:** ATP (ish AKKP) Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **22,458,705 lekë**, që i përket **7 rasteve** të tjetërsimit **më tepër të truallit me sipërfaqe totale 1612.2 m<sup>2</sup>**, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar nga personat si më poshtë:

- M A **shumën 9,143,947 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 304.2 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 395, datë 20.07.2015;
- B Ç **shumën 360,708 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 12 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 397, datë 20.07.2015;
- Z D **shumën 558,000 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 445, datë 23.10.2015;
- N T **shumën 4,963,750 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 250 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 420, datë 27.08.2015;
- Q L **shumën 1,789,800 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 470, datë 13.11.2015;
- A P **shumën 2,625,700 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 350 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 401, datë 20.07.2015;
- L H **shumën 3,016,800 lekë**, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 300 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 466, datë 13.11.2015;

**Brenda datës 30.04.2017**

**Gjetje 3:** ATP(ish AKKP) Tiranë, në procedurën e prokurimit me vlerë të vogël me objekt “Mirëmbajtje automjetesh” me fitues subjektin “A” Sh.p.k, konstatohet se për mjetin P me targa TR, për zërit nr. 5-*Amortizatori i parë*, është riparuar, në vlerën 18,400 lekë pa TVSh dhe 22,080 lekë me TVSh, për 2 copë, ndërkohë që i njëjti shërbim për të njëjtin mjet është realizuar në vitin 2014. Kryerja e këtij shërbimi 2 herë në një kohë më pak se një vit nuk justifikohet duke marrë parasysh jetëgjatësinë e pajisjes, për pasojë vlera **22,080 lekë me TVSH** është e pajustificuar dhe përbën dëm ekonomik (Trajtuar më hollësisht në faqe 56-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim 3 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej **22,080 lekë me TVSH** nga operatori ekonomik “A” Sh.p.k, si shpenzim i pa argumentuar.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 4:** Në procedurën e prokurimit “Sistemi Web-Gis informacioni për regjistrimin dhe vlerësimin e pronave objekt kthimi dhe kompensimi AKPP-Web-Gis” viti 2015, nga autoriteti kontraktor nuk janë aplikuar kamat vonesat **në vlerën totale 1,880,730 lekë** për mos realizimin në kohë të shërbimeve në kundërshtim me Nenin 22- Likuidimi i Dëmeve për dorëzimin e vonuar, pika 22.1, paragrafi i dytë të kontratës nr. 17/23 prot, datë 16.11.2015, për zërat si më poshtë:

- Zëri “*Trajnimi i përdoruesve*”, **në vlerën 216,000 lekë**

- Zëri “*Data entry*”, **në vlerën 1,664,730 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 29-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 4 :** ATP(ish AKKP) Tiranë, të marrë masa për kërkimin në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës totale prej **1,880,730 lekë** nga bashkimi i operatorëve ekonomik “C P & G C”, për mos realizimin në kohë të shërbimeve në kundërshtim me Nenin 22- Likuidimi i Dëmeve për dorëzimin e vonuar, pika 22.1, paragrafi i dytë të kontratës nr. 17/23 prot, datë 16.11.2015.

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 5:** Nga ATP Tiranë në 2 raste truell me sipërfaqe prej 307 m<sup>2</sup> është dhënë në kundërshtim me pikën 7 të VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012, Aneksi 1, mbështetur në neni 31 i VKM-së nr. 282/1961 neni 1 i dekretit nr. 4824/1971 ku përcaktohet se për ndërtimet e kryera nga data 16.8.1961 deri në 22.7.1978 sipërfaqja e truallit në qytete duhet të jetë 150-200 m<sup>2</sup>. Nga ku dëmi ekonomik si detyrimi i munguar në të ardhurat e buxhetit të shtetit dhe ATP është në vlerë prej 600,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 5:** Nga ATP të merren masa për kërkimin në rrugë ligjore e arkëtimin e vlerës prej **600,000 lekë** nga dy subjektet që kanë tjetërsuar me kundërshtim sipërfaqen prej 307 m<sup>2</sup>, konkretisht;

- E A sipas Vendimit nr. 58, datë 09.06.2016, në shumën 200,000 lekë

- M Ç, sipas Vendimit nr. 7, datë 16.02.2016, në shumën 400,000 lekë

**Deri në datë 30.04.2016**

**Gjetje 6:** Nga ATP Tiranë në 10 raste ka marrë Vendime për tjetërsimin e truallit “oborr në përdorim”, lidhur me sipërfaqen takuese të truallit nën objekt dhe “oborr në përdorim” në mospërputhje me përcaktimet ligjore; ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të Pronave” neni 5 pika 13; VKM nr. 578, datë 29.08.2012, i ndryshuar me VKM nr. 790, datë 14.11.2012 pika 7, Aneksi 1, mbështetur në neni 31 i VKM-së nr. 282/1961 neni 1 i dekretit nr. 4824/1971, neni 10 i dekretit nr. 5747/1978 ku përcaktohet se për ndërtimet e kryera nga data 16.8.1961 deri në 22.7.1978 sipërfaqja e truallit në qytete duhet të jetë 150-200 m<sup>2</sup>, duke tjetërsuar më tepër truallin me sipërfaqe totale **1,203.3 m<sup>2</sup>**, nga pronësia shtet tek subjektet private, për rrjedhojë ka krijuar dëm ekonomik si e ardhur e munguara në buxhetin e shtetit dhe buxhetin e ATP-së, **në vlerën 26,503,914 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqe 121-137 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Rekomandim 6:** Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë, të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **26,503,914 lekë**, që i përket 10 rasteve të tjetërsimit më tepër të truallit me sipërfaqe totale **1,203.3 m<sup>2</sup>**, në mospërputhje me përcaktimet ligjore, përfituar nga personat, pasqyruar më poshtë:

- **F K**, shumën 2,924,385 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 95 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 66, datë 10.06.2016.
- **K T**, shumën 2,050,466 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 229 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 14, datë 16.02.2016.
- **M B**, shumën 1,165,260 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 17.4 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 2, datë 16.02.2016.
- **M C**, shumën 4,327,768 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 138.4 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 65, datë 09.06.2016.
- **M K**, shumën 2,185,920 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 80 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 69, datë 23.06.2016.
- **R Gj**, shumën 936,570 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 30 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 61, datë 09.06.2016.
- **E S**, dhe **B S** shumën 4,003,581 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 367.2 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimet të ATP-së nr. 26 dhe 27, datë 16.02.2016.
- **N (S) B**, shumën 7,180,370 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 230 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 28, datë 27.04.2016.
- **A G**, shumën 1,099,594 lekë, që i përket vlerës së truallit me sipërfaqe prej 16.3 m<sup>2</sup>, të përfituar padrejtësisht më tepër sipas Vendimit të ATP-së nr. 29, datë 27.04.2016.

**Deri në datë 30.04.2016**

## **B/1-PËR MOSPËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE TË BUXHETIT**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), pasi të analizohen vlerat, të nxirren aktet administrative dhe zbatohen (Nëpunësi zbatues), për përdorimin me efektivitet të fondeve përbërë nga **vlera 41,355 mijë lekë** për vendimet e gjykatave për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies së punës, **vlera 379,989 mijë lekë** për 190 vendime Gjykatash për kundërshtimet atakimet e vendimeve të AKKP/ATP nga pronarët/trashëgimtarët, nga Avokati Shtetit apo palët e interesuara, të ardhurat e munguara potenciale deri në vlerën **431,257 mijë lekë** që rrjedh nga mostrajtimi dhe mbajtja tej afateve ligjore të 1134 dosje-kërkesa për tjetërsim të oborreve, dhe vlera **2,151 mijë lekë** që rrjedh nga mospërdorimi me efektivitet i fondeve të prokurimeve publike, në shumën totale prej **854,752 mijë lekë** si më poshtë:

1. Për në vlerën prej **41, 355 mijë lekë** të pagës së 41 punonjësve të larguar, vlerë e cila përbën **mbishpenzim për buxhetin e shtetit** rrjedhur nga vendimet e gjykatave për ndërprerje të njëanshme marrëdhënies së punës për periudhën para vitit 2013, viti 2013-30.06.2016, sipas tabelës pasqyruar në “Tabela Përmbledhëse Numri i Vendimeve të Gjykatës, Detyrimet dhe Likuidimet për Largimet nga Puna Periudha para v. 2012, 2013, 2014, 2015 dhe v. 2016 deri 30.06.2016” (*Trajtuar në faqet 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
2. Për vlerën prej **379,989 mijë lekë** nga e cila 289,763 mijë lekë për vlerën e kompensim-kthimit 11,916 mijë lekë për tarifë shërbimi dhe 6,900 mijë lekë shpenzime gjyqësore, nga të cilat janë likuiduar 137,663 mijë lekë, për 190 vendime Gjykatash për kundërshtimet e vendimeve të AKKP/ATP nga pronarët/trashëgimtarët, nga Avokati Shtetit apo palët e interesuara që kanë prodhuar detyrime, që rëndojnë fondin e kompensimit, sjellin mbishpenzim për buxhetin e ATP dhe të buxhetit të shtetit **pasqyruar** në tabelat emërtuar “Vendimet Gjyqësore 2014-2016 në atakim të vendimeve të marra nga ish-AKKP dhe ATP, për kthim dhe kryesisht për kompensim pronash me 5 fletë” dhe tabelën emërtuar “Përmbledhëse e Detyrimeve nga Vendimet e Gjykatave për

Atakimin e Vendimeve për kthim dhe kryesisht për kompensim të marra nga ish-AKKP dhe ATP, sipas kohës së Krijimit dhe likuidimet për periudhën 2014-30.06.2016 me 3 fletë” (Trajtuar në faqet 20-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.** Për vlerën prej **431,257 mijë lekë që rrjedh nga mostrajtimi dhe mbajtja tej afateve ligjore të 1134 dosje-kërkesa për tjetërsim të oborreve** (për tu përdorur në fondin e kompensimit, të ardhura të pa merituar për shërbim të pakryer e transparencë të pamjaftueshme ndaj qytetarëve në vlerën prej **3,402 mijë lekë**), pasqyruar analitikisht në tabelën emërtuar “Tabela Përmbledhëse të Ardhurat e Munguara dhe Dëme nga Vlera e Shitjes Oborreve dhe Tarifa e Shërbimit për Kërkesat e pa Trajtuar nga Sektori Oborreve Agjencia Trajtimit Pronave (ish-AKKP) 2009- 30/6/2016” (Trajtuar në faqet 89-95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Deri në datë 30.04.2016**

**4.** Në procedurën e Prokurimit “Shërbimi ruajtjes dhe sigurisë fizike për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave” viti 2015, me fond limit 2,532,326 lekë pa TVSH, nga ana e KVO-së është vepruar me dy standarde pasi për të njëjtat mangësi si listë pagesa të pakonfirmuara nga Organet Tatimore si dhe mungesa e dokumentacionin shoqërues që vërteton pronësin apo marrjen me qira të mjeteve janë skualifikuar operatorët ekonomik “L S”, “AG”, “K” “A” Sh.p.k dhe N.N.S, Sh.R.S.F, ndërkohë që operatori ekonomik “O” Sh.p.k është shpallur fitues edhe pse nuk i ka plotësuar këto kritere, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 1 - Objekti dhe qëllimi, Neni 2- Parimet e përzgjedhjes.

Në kushtet kur asnjë prej operatorëve ekonomik nuk ka përmbushur kriteret për kualifikim nga autoriteti kontraktor duhet të anulohet procedura e prokurimit dhe zhvillohet një procedurë e re. Si pasojë e veprimeve të mësipërme dhe mos anulimit të procedurës ka sjellë mos përdorimin me efektivitet të fondeve publike për vlerën **1,930,144** lekë pa TVSH, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” (Trajtuar më hollësisht në faqe 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.** Në procedurën e prokurimit Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, viti 2016, me fond limit 221,008,80 lekë pa TVSh, operatori ekonomik fitues “O” Sh.p.k nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit, dhe në këto kushte nga autoriteti kontraktor duhet të anulohet procedura e prokurimit dhe zhvillohet një procedurë e re. Si pasojë e veprimeve të mësipërme dhe mos anulimit të procedurës ka sjellë mos përdorimin me efektivitet të fondeve publike për vlerën **221,008** lekë pa TVSH, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve” dhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave” (Trajtuar më hollësisht në faqe 41-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe në ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, me ligjin nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” si dhe në kontratën individuale të punës, **ti kërkohet Drejtorit Përgjithshëm të ATP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga**

**puna**” dhe për ata me kontratë, nga masa **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për këta punonjës:

### C 1. Për punonjësit me kontratë që trajtohen sipas Kodit të punës

#### A.1. Masa **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për 10 punonjës si më poshtë:

**1. Për z. O Rr**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Kompensimit prej v. 2014 i komanduar, emëruar në v.2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr.2,4,5 ,7, 8,9 dhe nr.12 dhe aktverifikimi nr.1

**2. Për z. E L**, me detyrë Përgjegjës i përfaqësimit Ligjor prej v. 2015 për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 4 dhe nr. 8,

**3. Për znj. E B**, me detyrë Përgjegjëse Sektori (Tiranë Elbasan Dibër), sektorit kompensimit fizik, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 4, 7, dhe 8 dhe aktverifikimi nr.1 dhe nr. 6,

**4. Për znj. E I**, me detyrë Përgjegjëse Sektorit Financës prej 16.03.2014 e vazhdim, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 2, 5, 6, 7, dhe nr. 8 dhe aktverifikimi nr. 1,

**5. Për znj. E Ç**, me detyrë Përgjegjëse Sektori Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve v.2014 - vazhdim, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 2, 3, 6 dhe aktverifikimi nr. 1

**6. Për z. D B**, me detyrë ish Përgjegjës Sektorit Financës prej 02.12.2013 deri 26.02.2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 1, 2, 7, 11 dhe nr. 13,

**7. Për z. A L**, me detyrë inspektor jurist prej 24.05.2010 e vazhdim, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 1, 9, 11 dhe 13,

**8. Për z. J Ç**, me detyrë inspektor inxhinier prej 26.2.2014 e vazhdim, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 1,9,11 dhe 13,

**9. Për znj. M T (H)**, me detyrë inspektore juriste prej 7.05.2010 e vazhdim për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 1, 5, 9 13 dhe aktverifikimi nr. 1

**10. Për z. A M**, me detyrë ish inspektor jurist dhe Përgjegjës sektori Kompensimit Financiar fizik, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 5, 6, 10 dhe 12 dhe aktverifikimi nr. 1, 5, dhe 6,

#### A.2 .Masa **“Vërejtje”**, për 14 punonjës si më poshtë:

**1. Për z. G P** me detyrë Specialist IT, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 6 dhe 7,

**2. Për z. M B**, me detyrë inspektor, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 4 dhe 7,

**3. Për z. S M**, me detyrë jurist me cilësinë e kryetarit të Grupit të Punës sipas urdhrit nr. 416, datë 18.12.2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 2, 4 dhe 5.

**4. Për z. E M**, me detyrë specialist finance, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 5, dhe nr. 6.

**5. Për zj. J M**, me detyrë inspektor në Sektorin e kompensimit financiar e fizik, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 4, 10 dhe aktverifikimi nr. 5

**6. Për z. K D**, me detyrë Specialist IT, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 6 dhe 7,

7. *Për znj. E S*, me detyrë Specialiste për mangësitë trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalin nr. 3.
8. *Për z. B M* me detyrë Specialist për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 1, 6,
9. *Për znj. M T*, me detyrë ish-Përgjegjëse sektori Financë v.2014, specialiste v. 2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalet nr. 5, dhe aktverifikimi nr. 1
10. *Për z. E K*, inspektor-jurist (anëtar grupi prej v. 2015-2016) për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit procesverbal nr. 5, dhe aktverifikimi nr. 1
11. *Për znj. A Gj*, me detyrë Specialiste, për mangësitë trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbalin nr. 3.
12. *Për z. E K*, me detyrë i komanduar prej datës 26.02.2014-29.02.2014, aktualisht Specialist i Marrëdhënieve me Publikun, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.2 dhe nr. 8,
13. *Për z. Gj Xh*, me detyrë inspektor-jurist (anëtar grupi v. 2014-2015-2016), për mangësitë e trajtuara në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe procesverbal nr. 1, 6.

**B. Për 22 punonjës aktual nuk propozojmë masë pasi shkalla e shkeljeve në raport me pasojat në mirëfunksionimin e institucionit nuk është në nivelin për propozim masë disiplinore si më poshtë:**

1. *Për zj. E Sh*
2. *Për znj. J Ç,*
3. *Për znj. A Z,*
5. *Për znj. V K,*
6. *Për z. G H,*
7. *Për znj. A M,*
8. *Për znj. A K*
9. *Për znj. E K,*
10. *Për z. G S,*
12. *Për z. A L,*
13. *Për z. A Z,*
14. *Për z. Z P,*
15. *Për z. A R,*
16. *Për z. E K,*
17. *Për z. K P,*
18. *Për z. G D,*
19. *Për z. A H*
20. *Për z. N N,*
21. *Për z. T M,*
- 22 *Për z. V T,*

## C 2. Për Drejtuesit:

Mbështetur përveç sa sipër dhe bazuar pikën 7 të VKM nr 221, datë 23.03.2016 ”Për Mënyrën e Organizimit dhe Funkcionimit të Agjencisë të Trajtimit të Pronës”, ku shprehet: “*Drejtori i Përgjithshëm i ATP emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, ndërsa Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm*”; **ti kërkohet**

**Ministrit të Drejtësisë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për drejtuesin dhe marrjen e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri “Mos ngritje në detyrë deri 6 muaj”**

**1. Për z. L M**, me detyrë aktualisht zv. Drejtor i Përgjithshëm ATP dhe ish-Drejtor i Drejtorisë së vlerësimit dhe shpërndarjes së Kompensimit 2012-2013, për performancë të ulët në menaxhimin dhe drejtimin e ATP-së, tregues të nivelit të ulët në procesin e trajtimit e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave për periudhën Tetor 2013 deri Qershor 2016, si dhe mangësitë e shkeljet në procedurat prokurimit publik, trajtuar gjerësisht në faqet e Raportit Përfundimtar të auditimit dhe në procesverbalet nr. 3, 4, 5, nr. 8 dhe aktverifikimi nr. 1

### **PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.**

**I. Për 15 ish punonjësit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nuk rekomandojmë masa disiplinore.** Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga “vërejtje” deri në “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”, përkatësisht për:

**1. Për z. A T**, me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë së Kompensimit, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.8

**2. Për znj. M K**, me detyrë ish-Përgjegjëse Sektorit Financës deri datë 02.12.2014, aktualisht pension, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.2,5dhe nr.8,

**3. Për z. E Gj**, me detyrë ish-përgjegjës sektori (Durrës, Korçë, Berat) v.2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.2, nr.8 dhe Aktverifikimin nr.1,

**4. Për znj B G**, me detyrë Ish-Përgjegjëse Sektorit koordinimit Projekteve v.2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, nr.8 dhe Aktverifikimin nr.1,

**5. Për z.F D**, me detyrë ish-Përgjegjës sektori vlerësimit dhe shpërndarjes së Kompensimit, në Maj - Tetor v. 2013, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.4

**6. Për z. G S**, me detyrë ish- Përgjegjës Sektori për periudhën 05.05.2010– 8.10.2012, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**7. Për z.A N**, me detyrë ish-Përgjegjës Sektori për periudhën 11.9.2012 – 16.11.2012, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**8. Për z. A M**, me detyrë ish- inspektor jurist prej 7.5.2010 deri 18.2.2013, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**9. Për znj. B K**, me detyrë ish- inspektor inxhinierë prej 7.5.2010-18.2.2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**10. Për z. R N**, me detyrë ish- inspektor inxhinier prej 28.5.2010 -2.7.2012, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**11. Për z. B L**, me detyrë ish-inspektor jurist prej 2.5.2012 – 16.4.2013, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**12. Për z. A S**, me detyrë ish-inspektor jurist prej 12.10.2012 – 2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**13. Për z. Sh N**, me detyrë ish-inspektor inxhinier prej 21.12.2012-19.2.2014, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr. 1

**14. Për znj. A P**, me detyrë ish-inspektor jurist prej 20.01.2014-30.01.2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr.1

**15. Për znj. S Ç**, me detyrë ish- inspektore-juriste, (anëtar grupi v. 2014-15.09.2015), për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalin nr. 5

**Për 45 punonjësit aktual dhe 15 punonjësit e larguar përcaktuar më sipër masat kërkohen:**

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, ligjit nr. 133/2015, datë 05.12.2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, ligjit nr. 10 239, datë 25.2.2010, “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligjit nr. 9482, datë, 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, ligjit nr. 8485 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar me ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në procesin e trajtimit përfundimtar të pronës dhe të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për ATP Tiranë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**